



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 11.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për heqjen e sipërfaqes nga Fondi Pyjor dhe Kullotësor Kombëtar dhe zvogëlimin në vëllim të Fondit Pyjor Kombëtar në ngastrat e ekonomive pyjore Gojan – Shkozë, Gjegjan – Shkozë, Lumi i Zi, Lugina e Fanit të Madh, Qafëmollë, Fang, Spaç dhe Shkallëgjanë, të cilat preken nga ndërtimi i hidrocentraleve në Gojan, Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit dhe Fang”, që do të ndërtohen nga shoqëria “AYEN AS ENERGY”, sh.a.
3. Projektligji “Për shfuqizimin e ligjit nr. 10168, datë 22.10.2009 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG, sh.a”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Tom Doshi

Të ftuar:

Agim Bregasi – drejtor në Drejtorinë e Politikave të Planifikimit Strategjik për Energjinë në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Etleva Kondi – drejtoreshë në Drejtorinë e Koncesioneve, Prokurimeve,
Shpronësimeve dhe Privatizimeve në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Alba Thoma – drejtoreshë e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Mjedisit

Ylli Hoxha – drejtor i Drejtorisë së Pyjeve në Ministrinë e Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përsëritje!

Meqenëse formohet kuorumi, fillojmë mbledhjen e komisionit.

Pika e parë e rendit të ditës është projektligji “Për heqjen e sipërfaqes nga Fondi Pyjor dhe Kullotësor Kombëtar dhe zvogëlimin në vëllim të Fondit Pyjor Kombëtar në ngastrat e ekonomive pyjore Gojan–Shkozë, Gjegjan–Shkozë, Lumi i Zi, Lugina e Fanit të Madh, Qafëmollë, Fang, Spaç dhe Shkallëgjanë, të cilat preken nga ndërtimi i hidrocentraleve në Gojan, Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit dhe Fang”.

Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë kanë ardhur zoti Bregasi dhe zonja Kondi, ndërsa nga Ministria e Mjedisit kanë ardhur zonja Thoma dhe zoti Hoxha.

Zoti Ristani, keni fjalën.

Arben Ristani – Janë bërë disa seanca të këtij komisioni, por edhe të disa komisioneve të tjera parlamentare, ku deputetët e PD-së kanë një qëndrim tashmë të bërë të qartë dhe të stabilizuar. Ne mendojmë se nuk mund të ketë një axhendë tjetër normale të këtij parlamenti pa u prononcuar dhe pa u bërë edhe ju bashkë me ne për t’i kërkuar Kryetarit të Kuvendit që të japë dorëheqjen, në mënyrë që të paraqitet para drejtësisë jo si Kryetar Kuvendi, që t’i krijojë drejtësisë mundësinë të hetojë e lirë dhe e pandikuar nga politika. Kërkesa është serioze.

Gjendja është skandaloze. Kryetari i Kuvendit akuzohet se ka porositur vrasjen e dy deputetëve, që, për fatin tonë të keq, janë edhe deputetë të këtij komisioni, janë kolegët tanë, të cilëve u është kërcënuar jeta për shkak të porosisë, sipas tyre, të dhënë nga Kryetari i Kuvendit. Në këto kushte për ne nuk mund të ketë axhendë tjetër.

Ndërkohë kemi edhe një standard të vendosur tashmë nga vetë zoti Meta kur ishte zëvendëskryeministër, në kohën kur kishte edhe akuza të tjera korrupsioni me bllokun në dorë, ai dha dorëheqjen për t’u paraqitur pa funksione shtetërore përpara drejtësisë. Pra, këto janë standarde që ne duhet t’i respektojmë dhe t’i mbajmë, sepse na bëjnë mirë të gjithëve. Të njëjtin standard kërkojmë që të përkrahet dhe të vendoset edhe tani. Për ne nuk mund të ketë një axhendë tjetër përveç kësaj. Kështu që edhe ju, për mendimin tim, duhet t’i thërrisni logjikës suaj dhe të bashkoheni me ne, sepse është në të mirë të çështjes që Kryetari i Kuvendit të japë dorëheqjen për t’u paraqitur para drejtësisë.

Në këto kushte ne nuk mund të kemi axhendë tjetër dhe do të largohemi.

Fatmir Xhafaj – Kjo mbetet në çmimin tuaj.

Në vlerësimin tonë mbetet një absurditet dhe po kthehet në një gjë jo serioze edhe për qasjen ndaj parlamentit, edhe për qasjen ndaj qytetarëve, nëse dëshironi t'ua them edhe këtë gjë.

Për sa u përket standardeve, ky vend ka parë çudi dhe vetëm për standarde nuk mund të flitet. Nëse ka një standard, të cilin duhet ta respektojnë të gjithë është lejimi i drejtësisë të flasë dhe më pas mund të flisni ju, por për atë që do të vendosë drejtësia.

Kjo është një çështje që me vjen keq që përsëritet, saqë është kthyer në bast: do të ikë apo jo opozita! Gjithsesi, kjo çështje nuk është e jona!

Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit!

Ju lutem, përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit të na bëjnë një përmbledhje të shkurtër të këtij projektligji, ku të na thonë pse e kanë me kaq qejf të na prishin pyjet!

Ylli Hoxha – Ligji për heqjen nga Fondi Pyjor Kombëtar në ngastrat e ekonomive pyjore, të cilat përmythen nga baseni i hidrocentralit të “Ayen Energy”, është i bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 365, datë 04.05.2011 për miratimin e kontratës së koncesioneve të formës bot, e cila është lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministrisë së Energjetikës, si dhe bashkimit të shoqërive “Ayen AS Energy” sh.p.k për ndërtimin e hidrocentraleve Gojan, Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit dhe Fang.

Ministria e Mjedisit e ka hartuar projektligjin bazuar në detyrimet ligjore, të cilat rrjedhin dhe bazohen në nenet 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës, si dhe në strategjinë ndërsektorale të energjisë, e miratuar në Këshillin e Ministrave.

E ndodhur para këtij fakti Ministria e Mjedisit, bazuar në kriteret e referuara karshi sipërfaqes, ka hartuar projektligjin për heqjen nga fondi pyjor të këtyre sipërfaqeve.

Fatmir Xhafaj – A keni ndonjë gjë tjetër jashtë relacionit për ta sqaruar komisionin? Nuk keni.

Ministria e Energjetikës e ka të domosdoshme ta bëjë këtë gjë?

Etleva Kondi – Kjo është një procedurë koncensionit, e cila është miratuar me VKM pasi e kalon vlerën e rreth 20 milionë eurove. Ndërtimi i kësaj veprë energjetike parashikohet të ketë një kapacitet 87 megavat prodhimi dhe një vlerë investimi 16 miliardë lekë. Kjo është një vepër që do t'i përmirësojë ndjeshëm treguesit e energjisë elektrike. Këto janë detyrime,

të cilat kontrata koncesionare i ka parashikuar tashmë për heqjen nga fondi pyjor i sipërfaqes mbi 100 hektarë.

Gjatë monitorimit të procesit kjo është një procedurë që përfundon në afat.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Uroj ta kenë marrë vesh këta që janë këtu!

Fjalën e ka zoti Muçmataj, si relator i kësaj çështjeje.

Vexhi Muçmataj – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne jemi komision për dhënie mendimi për këtë projektligj.

Ky projektligj, siç e thanë edhe përfaqësuesit e dikastereve, ka për qëllim heqjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore nga Fondi Kombëtar Pyjor dhe vënien e tyre në dispozicion për ndërtimin e hidrocentraleve.

Ky projekt është në respekt të ligjeve të veçanta, qoftë të ligjit “Për pyjet dhe shërbimet pyjore”, qoftë të ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”. Pra, në aspektin ligjor ai respekton kërkesat e Kushtetutës dhe të ligjeve të veçanta që rregullojnë këto marrëdhënie, ndërsa në aspektin procedural respekton Rregulloren e Kuvendit.

Për sa i takon teknikës legislative, mendoj se ka vend për të bërë disa rregullime, të cilat duhet që t’i rishohim edhe një herë me përfaqësuesit e ministrive.

Duke e parë në tërësi projektligjin, mendoj që ta miratojmë për ta kaluar në seancë plenare.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Muçmataj, për opinionin tuaj për ta miratuar këtë projektligj!

Kalojmë në pyetje.

Zoti Fino, keni fjalën.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Të bësh diçka, do të prishësh diçka. Këtu ka ardhur një projektligj, që kërkon zvogëlimin e fondit pyjor prej 600 hektarësh për t’ia dhënë firmës që të bëjë hidrocentrale.

Pyetja ime lidhet me nenin 3, zoti kryetar, e cila nuk është i detajuar, prandaj kërkoj të na e sqarojnë në mënyrë të hollësishme, me qëllim që ne të llogarisim se sa do t’i vëmë pyjet nesër në funksion, sipas Ministrisë së Mjedisit. Në nenin 3 thuhet: “Llogaritja e volumeve dhe kryerja e pagesave sipas përdorimit”. Sa janë ato?

“Përcaktimi i sipërfaqes për pyllëzim dhe ripyllëzim në secilën ekonomi”. Në këtë kontratë si është arritur marrëveshja dypalëshe dhe sa do të jetë përcaktimi i sipërfaqes për pyllëzim? Pra, ne do të heqim 600 hektarë, por sa hektarë do të ripyllëzojmë, ose do t’i

shfrytëzojmë përsëri, apo do t'i bëjmë të rinj? A do të kemi mundësi t'i rikthejmë në Ministrinë e Mjedisit këto hektarë të pyjeve kombëtare, apo jo? Si do t'i hartoni projektet teknike për hapjen e materialeve drusore të pyllëzimit?

Neni 3 mua më duket shumë i rëndësishëm, zoti kryetar, por është vetëm deklarativ, sepse nuk ka asnjë shifër konkrete që të na vërtetojë se këto 600 hektarë pyje, të cilët po hiqen për shkak se duhen bërë këto hidrocentrale, do të zëvendësohen me të paktën 300 hektarë të tjerë, ose 200 hektarë, ose asgjë.

Pra, ne duhet ta dimë kur të votojmë këtë projektligj. Është e rëndësishme edhe vlera prej 20 milionë eurosh, që do të investohet për hidrocentralet, edhe vlera e 87 megatvatëve, që do të ndërtojë kompania për hidrocentralet, sepse edhe energjia është shumë e rëndësishme për shtetin tonë, por natyrisht të rëndësishme janë edhe këto 600 hektarë. Kjo gjë nuk trajtohet saktë dhe drejt, të paktën me shifra konkrete. Unë dua të di më tepër sesi do të përkthehet neni 3 i këtij projektligji?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Përgjigjja juaj.

Ylli Hoxha – Realisht neni 3 nuk ka përcaktuar gjë. Të gjitha përcaktimet vijnë me një marrëveshje, e cila lidhet ndërmjet subjektit në lidhje me detyrimet, bazuar edhe në ligjin nr. 10431 “Për mbrojtjen e mjedisit”, parimi i zëvendësimit. Gjithashtu, bazuar në urdhrin e ministrit të Mjedisit nr. 1937, kompania e ka për detyrim të pyllëzojë 461 hektarë. Njëkohësisht, pasi ky ligj të miratohet, ne do të lidhim marrëveshjet përkatëse me kompaninë për detyrimet e pyllëzimit.

Kompania është e detyruar që të rehabilitojë dhe të zëvendësojë fondin pyjor që mbyt me trefishin e sipërfaqes, në rast se këto pyje quhen pyje trungiste, ose të larta. Po ashtu ka për detyrim të pyllëzojë ose të rehabilitojë ekuivalent me sipërfaqen që mbyt në rast se këto sipërfaqe në terminologjinë teknike njihen me sipërfaqe cungiste, janë pyje të ulëta. Në rast se kompania me këto basene mbyt sipërfaqe inproduktive, domethënë shkëmbore, pa bimësi, kompania nuk e ka për detyrim të pyllëzojë, sepse këto sipërfaqe konsiderohen inproduktive. Duke qenë se kompania është e detyruar të paguajë të gjitha volumet dhe asetet natyrore që gjenden në sipërfaqet që mbyten, është e detyruar t'i dëmshpërblejë.

Dëmshpërblimet ose pagesat për këto asete që mbyten nga baseni që krijohet, kompania është e detyruar t'i bëjë me komunën, në rast se kemi të bëjmë me pyje komunale, dhe me drejtoritë e shërbimit pyjor, në rast se janë pyje shtetërore ose pyje që administrohen nga Ministria e Mjedisit dhe strukturat përkatëse.

Ashtu siç ju thashë, e rëndësishme për ne është që sapo të miratohet ky ligj, (ligji ka edhe një tabelë që ka dalë nga kadastra kombëtare) kompania për të gjitha sipërfaqet trungiste është e detyruar të rehabilitojë trefishin e tyre.

Mbi bazën e kalkulimit që ne kemi bërë, marrëveshjen e kemi të gatshme, kompania ka për detyrim të pyllëzojë 461 hektarë. Normalisht, detyrimin për pyllëzim kompanitë zakonisht e bëjnë mbi sipërfaqet e rregulluara, sepse kërkojnë të mbrojnë edhe basenin përmbledhës nga prurjet e ngurta, por kjo mbetet në dëshirën e institucioneve relevante në këtë marrëveshje.

Pyetja ishte në një sens tjetër, besoj. Do të të këshilloja t'i ndiqnit me vëmendje pyetjet e deputetëve, sepse këtu nuk është çështja se çfarë keni në mendje ju, por pse nuk është në ligj kjo gjë. Pse lihet fakultative në dëshirën tuaj, si drejtor, apo të ministrit, dhe nuk lihet në imponim dhe urdhërim të ligjit, sepse forca që ka ligji është shumë herë më e madhe, me gjithë respektin që kam për ju dhe institucionin që përfaqësoni, sesa marrëveshja e palëve. Nëse do të ishte në ligj, do të jetë detyruese, respektuese, kontrolluese dhe me përgjegjësi ligjore.

Zonja Hysi.

Pastaj zoti Klosi dhe zoti Peza.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

I rikthehem shqetësimit që ngriti zoti Fino. Meqë neni 3 është shumë i përgjithshëm, kam një pyetje: kur jepen këto lejet koncesionare, kjo është dhënë në vitin 2011, a është bërë ndonjë studim i përfitimeve që do të sjellë zbatimin e ndërtimit të këtyre hidrocentraleve, në krahasim me dëmet që shkakton ndërtimi i tyre?

Pyetja e dytë. Ju thoni se do të hiqen nga fondi pyjor 600,98 ha, ndërkohë që në nenin 4 thoni: duhen pyllëzuar 453,73 ha, brenda tre vjetësh. Pse ka një diferencë midis sasisë që hiqni nga fondi dhe zëvendësimit të tyre? Në mos gaboj, në fjalën tuaj të fundit thatë se kjo lihet në dëshirën e drejtuesve të institucioneve. I rikthehem pyetjes që bëri kolegu Fino: pse nuk e dini sasinë e fondit që i largohet çdo komune apo bashkie, po i lini të përcaktohen më vonë? Si është miratuar ky koncesion, pa ditur se ku do të shtrihet? A ka pasur një plan zhvillimi? Neni 3 është sikur çdo gjë do të fillojë tani dhe ju nuk e dini se ku do të shtrihet investimi.

Pyetja e tretë është në lidhje me dëmet që shkaktohen. Ju thoni, në nenin 3, që do të llogaritet volumi dhe do të kryhen pagesat sipas pronësisë dhe përdorimit. Cili është dëmi që do të shkaktohet? Është vetëm fondi i pyjeve, apo ka vepra arti, rrugë, banesa dhe biznese?

Nëse ka, pse nuk përcaktohen në mënyrë të detajuar detyrimet? Kush do t'i përmbushë ato, në varësi të dëmeve që do të shkaktohen nga përmbytja?

Për kureshtje: kjo kompani është shqiptare apo e huaj? E njeh terrenin kjo kompani? E dinte ajo se çfarë do të përmbyste? Pse i lini kaq shumë kohë, tre vjet, që të bëjë pyllëzimin? Ku do ta bëjë, në cilat zona?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Bregasi.

Agim Bregasi – Po e nis nga pyetja: a ka një studim për përfitimet dhe për dëmet?

Natyrisht, çdo projekt ka studim për prodhimin e energjisë elektrike, i cili është primar, por ky projekt shoqërohet edhe me një sërë studimesh të tjera, ku njëri nga më të rëndësishmit është edhe ai mjedisor. Natyrisht që dihet saktë se ku do të kalojë traseja, ku do të bëhet ndërtesa e centralit, ku do të kalojë kanali, ku do të jetë vepra e marrjes dhe ku do të jetë nënstacioni. Të gjitha janë të përcaktuara dhe ka një projekt zbatimi.

Sipas projektit të zbatimit, i cili shqyrtohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe miratohet nga autoriteti kontraktues, kompania zbatuese do të bëjë edhe vlerësimin e dëmeve mjedisore, nëse është pranuar nga studimi mjedisor që ka dëme. Në bazë të këtij studimi, kompania përcakton sipërfaqet që duhet të shpyllëzohen, për t'u ripyllëzuar etj. Të gjitha këto janë të përcaktuara dhe i kalojnë Ministrisë së Mjedisit për të bërë përputhshmërinë me projektin e zbatimit, pastaj bëhet tabela, që e përmendët ju dhe zoti Fino, se cilat janë drusore, cilat janë shkurre dhe cilat janë pa produktivitet. Pra, ka një vlerësim të të gjitha ardhurave që vijnë nga prodhimi i energjisë, dëmeve në mjedis, që mund të jenë të përkohshme, dhe mënyra e kompensimit mjedisor në aspektin pyjor, meqë jemi në këtë aspekt. Bëhet ndarja me ngastra, se cilës komunë i takon, madje edhe me persona, bëhet vlerësimi i sipërfaqes etj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Iu përgjigja pyetjes që ka studim, që ka kaluar në të gjitha procedurat dhe është miratuar me VKM.

Puna e vlerësimit apo e problemeve mjedisore, sa shpyllëzohen, sa kompensohet etj., është detyrë e Ministrisë së Mjedisit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni.

Ylli Hoxha – Në lidhje me pyetjet e tjera, dëshiroj të shpjegoj se aktualisht në ligjin “Për administrimin e pyjeve në Republikën e Shqipërisë”, që është ligji nr. 9385, ka një vakum ligjor, sepse ai është miratuar në vitin 2005, ndërsa marrëveshjet si këto kanë dalë më pas.

Në ligjin e ri të pyjeve, që e kemi në proces – besoj, shumë shpejt do të jetë në duart tuaja për analizë – e kemi futur konceptin ekzakt, me shifra, se sa duhet të dëmshpërblejnë ekonomitë, ose operatorët ekonomike, që operojnë me veprimtari ekonomike mbi fondin pyjor. Për këtë problematikë, ne si ministri, bazuar edhe në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”, konkretisht në parimin e zëvendësimit, kemi marrë detyrim trefish. Parimi i zëvendësimit thotë: ajo që priset, dëmshpërblehet. Ne themi: ajo që prish, do të paguhet, por edhe do të rehabilitohet diku tjetër.

Në lidhje me atë që ikin 600,98 ha dhe aktualisht rehabilitohen 461 ha, e përmendur edhe në nenin 4, ju sqarova më parë që me një urdhër të mjedisit kemi bërë një kalkulim në lidhje me asetet që ndodhen aktualisht. Sipërfaqja e pyjeve rugishte rehabilitohet me trefishin e sipërfaqes, sepse kanë vlerë të lartë. Për rastin konkret, shifra në nenin 3 i është referuar tabelës që ka dalë nga Kadastra e Pyjeve, ose Regjistri Kombëtar i Pyjeve. Po të dalim te detajet, unë kam tabelat përkatëse këtu. Shifra ka dalë nga detyrimi që ka kompania për të zëvendësuar trefishin e sipërfaqes për pyjet rugishte, ekuivalente me pyjet cungishte dhe me format e tjera të qeverimit.

Duhet ta dini që kompanitë llobojnë fuqishëm dhe ne jemi në presion të vazhdueshëm nga të gjitha ministratë, sepse thonë që operojnë në Shqipëri dhe janë në interesin tonë. Bilancet, ashtu siç e përmendi edhe kolegu nga Ministria e Energjisë, janë pozitive.

Dal te pyetja e fundit: pse afat 3-vjeçar? Kompania është në procesin e investimit. Janë investime të konsiderueshme. Për këtë qëllim, kompanitë hyjnë në negociata dhe thonë që t’ua shtyjme investimin në kohë, sepse edhe investimi që duhet të shfrytëzojë kompania për ripyllëzim, është jo i vogël. Projekti ka një vlerë diku te 1 milion dollarë, për detyrimin që ka për ripyllëzimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Blendi Klosi – E vlerësoj shumë lirshmërinë e kolegëve dhe i bashkëngjitem me shumë pasion historisë mjedisore.

Pyetja ime shkon për koncesionarin. As në relacion, as në projektligj nuk ka një shpjegim se kur është dhënë ky koncesion dhe a e ka zbatuar atë pjesën e parë, siç tha edhe

zoti Fino, të investimit-investim, sepse kemi një numër shumë të madhe koncesionesh të dhëna në atë periudhë dhe shumë pak prej tyre janë në zhvillim e sipër.

Pyetja e dytë i bashkëngjitet pyetjes që bënë kolegët. Nuk e kam për nenin 3, por për nenin 4, i cili është një detyrim për pyllëzim, thua se me kaq mjafton historia. Se çfarë do të thotë pyllëzim nuk shpjegohet. Pyetja shkon drejtpërdrejt te ju, të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, që do të bëni avokatinë e mjedisit dhe të investimit, siç e tha edhe zoti Fino.

Pyetja është: kur ka ndodhur në raste të ngjashme?

Unë jam deputet i qarkut të Durrësit. Në zonën Krujë dhe Fushë-Krujë ka me dhjetëra gurore, ka fabrikë çimentoje, të cilat kanë pasur detyrime shumë të mëdha që ta pyllëzonin atë zonë. Realisht, e kam të vështirë të gjej një zonë të pyllëzuar nga kompanitë koncesionare që kanë pasur detyrimin ta bëjnë.

Në rastin e hidrocentraleve, a keni raste kur pyllëzimi është realizuar? Kjo është pyetja e parë.

Në rastin e dytë, ku do të kryhet ky pyllëzim nga kompania përkatëse? Dhe çfarë do të thotë pyllëzim? Mbase ne nuk e njohim mirë pyllin, kurse ju keni informacion më shumë. Për çfarë standardesh bëhet fjalë në koncesionin përkatës? Çfarë lloj pylli presin aty dhe kur e presin?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Klosi!

Zotërinjtë e dy ministrive, të Energjisë dhe të Mjedisit?

Etleva Kondi – Një përshkrim i shkurtër, që i bëmë pak më përpara kontratës koncesionare, nuk e di se pse nuk është vënë në projektligj, megjithatë mund t’ju informojmë që është një kontratë koncesionare e lidhur në vitin 2011. Me miratimin e projektit të zbatimit, marrjen e të gjitha lejeve dhe me miratimin e lejes së ndërtimit, koncesionari ka filluar punimet në afat dhe në fund të marsit do të vërë në punë dy nga HEC-et e veta, me një kapacitet rreth 10 mega, siç e ka parashikuar në grafikun e punimeve. “AYEN Enerji” është kompani turke, goxha e njohur edhe në Turqi. Ajo ka realizuar kontrata koncesionare dhe ka koncesione në Turqi. Me sa e kemi monitoruar, bashkë me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, punimet po ecin në afat dhe sipas parashikimeve.

Pyetja tjetër ishte për kolegun.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Nga mjedisi?

Ylli Hoxha – Më vjen keq që cilësohem si avokat i kësaj sipërmarrjeje. Nuk jam avokat i saj dhe as i ndonjë sipërmarrjeje tjetër. Më vjen shumë keq! Desha të sqaroj pozicionin tim.

Në lidhje me raste të tjera të ngjashme, së paku në momentin që unë jam në pozicionin e drejtorit të pyjeve – jam që nga marsi i viti të kaluar – kemi rastin e “Devoll Hydropower”, një kompani që ndërton mbi kaskadën e lumit Devoll dhe ka detyrim pyllëzimi 3000 ha, ndërkohë që vetëm për vitin 2014 ka realizuar një pyllëzim prej 700 hektarësh. Detyrimin për rehabilitim dhe pyllëzim e ka të shtrirë në pesë vjet. Nuk di t’i them shkaqet, por kështu është vendosur.

Sipërfaqja e pyllit që krijohet, jo ajo që është zhdukur, është e një standardi pyje artificiale, janë pyje që kryesisht ne tentojmë, këto janë projektet që sillen nga kompanitë dhe pretendojmë ta konvertojmë mbylljen në të njëjtat ekuivalenca, siç është ai natyrali. Normalisht, dua t’ju sqaroj gjërat se nuk është më natyral. Ne pyjet që na mbyten, për shembull, në kaskadën e Devollit janë pyjet tryngiste, ose cungiste të llojit dushk ose lis. Ne nuk kemi fidanë të tillë në treg jo në vend, por as në rajon. Fidanët e dushqeve vijnë vetëm nga Irlanda që kanë një kosto normalisht të shtrenjtë dhe ne detyrohemi të ulim sipërfaqen nëse marrim fidan nga Irlanda. Statutura e pyjeve të formuara janë pyje trungiste jo natyrale, por artificiale. Në parametrat e mbrojtjes nga fenomeni erozionit dhe në parametrat e stogut të karbonit, këto janë pyje më të mirë sesa pyjet që ne kemi aktualisht, natyralë sepse janë pyje të mbishfrytëzuara për shkak të nevojave të tregut të popullsisë vendase etj.

(Diskutim, pa mikrofon.)

Po, patjetër.

Kemi dhe rastin e ANTEA-s, ose fabrikën e çimentos në Krujë, që ka pyllëzuar malet e Krujës dhe po vazhdon të pyllëzojë edhe në momentet që ne po flasim. Është një detyrim prej 300 hektarësh që ka në proces.

Në lidhje me guroret, që operojnë në zonën e Makareshit të Krujës, është bërë një luftë e jashtëzakonshme nga ana jonë si Ministri e Mjedisit, gjithashtu dhe nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Ne vitin e kaluar në mars kemi pezulluar të gjithë aktivitetin e tyre. Gjithashtu, vitin e kaluar kemi ndërhyrë me një projekt rehabilitimi në një sipërfaqe prej 36,5 hektarësh, fonde të cilat i kemi siguruar nga Fondi Zhvillimit të Rajonit, dhe projekti ka përfunduar. Të gjithë duhet dimë të gjithë një gjë: pyjet janë të fundit kur vjen momenti për të dhënë mendimin. Ka ndodhur çdo gjë, edhe ligji na e lejon, që të bëjmë aktin e heqjes nga fondi pyjor.

Në ligjin e ri që kemi në proces ...

(Diskutim pa mikrofon.)

Është mbështetje aktuale dhe ne e mirëkuptojmë këtë, por ligjet na detyrojnë dhe na bëjnë aktorin e fundit në këtë lloji zinxhiri veprimesh.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Fjalën e ka zoti Peza dhe e mbyllim me pyetjet.

(Diskutim pa mikrofon.)

Ju lutem, ndizeni mikrofonin, sepse nuk ju regjistrohet gjë!

Dashamir Peza - A ka ndonjë oponencë të pavarur nga një institucion, organizatë që ka të bëjë me ndotjen e ambientit?

E treta, nëse këtu u tha që ka vakuum ligjor dhe po përgatisim ligjin e ri, mos është më mirë të presim ligjin e ri dhe këtë ligj ta kalojmë pasi të kemi mbushur boshllëkun, ose vakuumin ligjor që kemi, siç u tha këtu nga përfaqësuesit e administratës?

Kur flisni për konsekuenca ambientale, për rreziqe në ndikimin në ambient, me këtë kuptoni vetëm zëvendësimin e druve, apo mendoni se ka dhe aspekte të tjera, të cilat janë të domosdoshme për t'u shqyrtuar? Personalisht dyshoj se efektet e këtyre ndërhyrjeve dhe investimeve mund të lidhen vetëm me çështjen e zëvendësimit të disa druve. Dua të di a ka rreziqe të tjera?

Për ta mbyllur, e kisha për ju, zoti kryetar, a mundemi ne të ftojmë ndonjë organ të specializuar, të pavarur për të pasur një oponencë dhe një zë tjetër lidhur me këtë projekt?

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Për tri pyetjet e tjera do t'u përgjigjen përfaqësuesit e ministrive. Në lidhje me këtë që më adresuat dua t'ju them se ne nuk jemi komision përgjegjës, komisioni përgjegjës është Komisioni i Veprimtarive Prodhuese. Gjithsesi, në relacionin që do t'i paraqesim komisionit përgjegjës, pa dyshim të gjitha këto do të ngrihen, që ata t'u japin përgjigje në draftin final që do t'i paraqesin seancës.

Njëkohësisht do t'u kërkohet që të thirren prej tyre struktura të specializuara, shoqëria civile apo ekspertë të tjerë për t'ju dhënë një përgjigje, nëse është e domosdoshme.

Dashamir Peza - Zoti kryetar, meqenëse mua, ashtu si të gjithë ju, do të më duhet të votoj, dua të më vini në dijeni në qoftë se ndonjë organizatë, apo shoqatë e shoqërisë civile do të marrë pjesë, sepse dua ta dëgjoj përpara se të marr vendimin.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Do t'ia kërkoj zyrtarisht Komisionit të Veprimtarive Prodhuese që ta bëjë këtë gjë.

Etleva Kondi - Në lidhje me oponencën, oponenca teknike shtetërore është bërë. Në fakt, në bazë të ligjit detyrimi është që përpara kalimit të mbrojtjes së studimit të fizibilitetit bëhet oponencë teknike shtetërore në AKBN, e cila përbëhet nga specialistë ndryshëm. Në përbërje të grupit të kësaj oponence është edhe një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit. Pjesë e studimit të fizibilitetit, sepse ka kaluar dy herë kjo kontratë koncesion, kemi:

Së pari, procesin e identifikimit të projektit, që kalon një herë për marrjen e bonusit nga ministritë përkatëse, pasi miratohet me vendin të Këshillit të Ministrave.

Së dyti, projektin përfundimtar, që është projekti i zbatimit. Ky projekt shikohet nga specialistë të mjedisit dhe në detyrimin ligjor nuk ka ndonjë oponencë të pavarur që mund të bëhet paraprakisht.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka zotëria i Ministrisë së Mjedisit.

Ylli Hoxha - Ashtu siç tha edhe kolegia, normalisht të gjitha projektet shoqërohen me një vendim të ndikimit në mjedisit, ku operatori është i detyruar të nënkontrakttojë një kompani, e cila është e licencuar për të kryer një vendim të tillë.

Edhe ky projekt besoj se e ka pasur një të tillë, megjithëse shtrihet herët në kohë, në momentin që unë skam qenë në këtë pozicion. Por besoj se është pajisur përderisa ka marrë lejen mjedisore, sepse leja mjedisore që i jepet projektit bazohet mbi vendimit e ndikimit në mjedis. Normalisht ka kaluar të gjitha oponencat, dhe oponencat janë të të gjithë institucioneve jo vetëm të Ministrisë së Mjedisit, por edhe të Ministrisë së Kulturës, të studios së monumenteve të kulturës, sepse ka objekte të trashëgimisë kulturore, ose objekte arkeologjike në zonë.

Për të dalë te përgjigjja jonë që ka rreziqe të tjera, përveçse drurët dhe rehabilitimi i sipërfaqeve pyjore, ne jemi përgjegjës për aspektin e fondit pyjor dhe jemi obligatorë për të zëvendësuar asetet që realisht na humbasin. Për të tjerat ka ministri përgjegjëse, siç është Ministria e Kulturës për objektet e trashëgimisë kulturore, ose objektet arkeologjike të zonë, Ministria e Infrastrukturës për rrugët që mund të përmyten, por në këtë rast, në dijeninë time, nuk përmyten rrugë apo vepra të tjera.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - E mbyllim këtu me pyetjet.

Kush ka diskutime?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Zoti kryetar, unë thjesht dua t'ju kërkoj falje që fola pa leje dhe Ministrisë së Mjedisit që pa dashur e bëre, avokat, megjithëse thënia ime, për firmën sesa për mjedisin, e detyroi atë të thoshte tani nga fundi, që ligji na detyron ne që të jemi aktorët e fundit, dhe të japim dakodësinë për raste të kësaj natyre. Pa ta kishe thënë këtë që në fillim do të ishte komplet shumë më ndryshe. Unë vetëm dy fjali kam për të thënë, dhe dua të jem konkret. Po ndërtohen katër hidrocentrale, në Gojan, në Gjegjan, në Peshqesh dhe në Urën e Fanit, dhe po hiqen 600 hektarë tokë dhe pyllëzime nga fondi i pyjeve; kjo është kryesorja. Ajo që më bën të jem pak skeptik dhe që dua të jem i saktë në atë që do të votoj, është që te neni 3, dhe me çfarë pashë edhe kolegët e tjerë deputetë në përgjithësi rreth atij neni e bënë pyetjet më të sakta, ne duhet të vëmë detyrim që të dyja palët të jenë të kontraktuara në ligj.

Parlamenti ka të drejtë t'i miratojë, zoti kryetar, dhe t'i kontrollojë këto koncesione dhe këto detyrime të palëve. Meqënëse ligji është forma më e lartë e marrjes së një vendimi sesa një marrëveshje midis dy palëve, e Ministrisë së Mjedisit me koncesionarin apo me firmën, do të ishte më e ndershme që këtë neni 3 të mos ishte deklarativ, të ishte më i përgjithshëm, por në qoftë se neni 3 do të ishte me ato sqarime që dhanë përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Mjedisit mbase do të ishim edhe ne më të qetë në sensin për të tejkaluar këtë projektligj dhe për ta miratuar atë. Prandaj unë do të kërkoja nga ju si kryetar, por edhe nga përfaqësuesit e ministrive, që në qoftë se do të kishin mundësi ta rishikonin nenin 3 për ta afruar me ato shqetësime që kolegët e mi deputetë dhe unë bëmë në këtë projektligj, për të trajtuar dhe për të vënë pika konkrete në detyrimet midis palëve. Në qoftë se do t'i vinim aty, do të ishin më të kontrollueshme, edhe firma do të ishte më korrekte, edhe ministria do të ishte më korrekte në raport me firmën dhe nuk do të kishim hasur probleme me njëri –tjetrin. Në të kundërt unë nuk e shikoj... Jam dakord me projektligjin, dua ta them që në fillim, por nuk jam dakord me nenin 3 për të cilin do të votoj kundër.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Majko, pastaj zoti Manja.

Pandeli Majko – Unë mendoj që ashtu siç u shprehën edhe ekspertët këtu është bërë një punë paraprake të cilën do ta konsideroja të dobishme dhe me një investim i cili është vërtet i rëndësishëm, edhe për zonën, edhe për ekonominë. Mendoj që në këtë pikë nuk ka çfarë diskutojmë, por do të më lejoni që ekspertiza e ministrive të mirëkuptojë disa shqetësime që unë do të ngre.

Në nenin 4 “detyrimin për pyllëzim” keni shprehur që kompania me fondet e veta do të bëjë pyllëzimin e një sipërfaqeje prej 458,73 hektarësh me dru pyjorë, citoj: “ në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen e përmendur në nenin 3 të këtij ligji. “Po e përsëris, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen e përmendur në nenin 3 të këtij ligji.”

Kthehemi në nenin 3 të këtij ligji.

Në nenin 3 të këtij ligji nuk ka asnjë ngastër, por ka thjesht një terminologji të përgjithëshme që thotë, detyrimet e palëve. Tani besoj që më mirëkuptoni që ju keni sjellë një marrëveshje në të cilën ngastrat që do të shpyllëzohen janë të emërtuara pikë për pikë, ndërsa marrëveshjen për ngastrat që do të ripyllëzohen, ju e keni lënë komplet subjektive. Kam mirëkuptimin tuaj të plotë për të më thënë që kjo mbase është një fazë e dytë, nuk kemi pasur kohë, kjo do të negociohet, e kështu me radhë. Mirëpo, shikoj që marrëveshja është firmosur në 2011-n. I marrim me radhë 2011, 2012, 2013, 2014, 2015. Përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit tha se, kur është bërë marrëveshja, unë nuk kam qenë. Më mirëkuptoni dhe besoj që vini nga një eksperiencë administrative të gjithë sesi ndyshojnë drejtorët në Republikën e Shqipërisë, jo në 4 vjet por edhe në më pak. Ju keni sjellë një marrëveshje ku thuhet se ngastrat përcaktohen në nenin 3, në nenin 3 nuk ka asnjë ngastër, në një kohë që për gjithçfarë do të shpyllëzohet, ne do ngremë votën dhe gjithçka që do të pyllëzohet ne nuk e dimë. E di ju që do negocioni me kompaninë. Deri më sot, në Republikën e Shqipërisë nuk ka pasur ndonjëherë ndonjë shembull superpozitiv që një kompani të bëjë një marrëveshje me një Ministri Mjedisi apo me një qeveri e cila, do të ketë të bëjë me një pyllëzim jashtëzakonisht masiv, ndoshta projekti i pyllëzimit më masiv pas viteve 90, më korigjoni në qoftë se e kam gabim, pasi bëhet fjalë, citoj: “ për një pyllëzim me sipërfaqe 458,73 hektarë. Tani, pa përcaktuar ngastra, gjithçka e lënë në një marrëveshje hipotetike, e cila do të vlerësohet nga ana juaj, pa vënë në dyshim aspak ekseptizën që ju zotëroni, më mirëkuptoni, por do të thosha që ne duhet të paktën të kemi të drejtën të shtrojmë edhe pyetjen: e kemi vënë kompaninë në të njëjtën llogjikë barazie midis interesave të shtetit shqiptar dhe interesave të saj? Sepse kur vjen fjala për interesat e saj ne i themi fjalë për fjalë, emër për emër të gjitha ngastrat pyjore që do të shpyllëzohen, dhe kur vjen puna për detyrimet që duhet të ketë kompania karshi shtetit shqiptar, ne e themi atë që ngastrat te neni 4, por ngastra s’ka. Prandaj besoj që më mirëkuptoni në ngritjen e këtyre shqetësimeve, duke nënvizuar gjithmonë që kemi të bëjmë me një investim shumë të rëndësishëm, por e kemi edhe atë fjalën e vjetër, që edhe midis vëllezërve thonë, “vëlla – vëlla, por qesja në mes.” Kështu që do t’ju lutesha duke qenë se kemi të bëjmë me një kontratë koncesionare

goxha të vjetër në kohë, në mos gaboj 5 – vjeçare, ne kemi të drejtën të pyesim gjatë këtyre 5 vjetëve, se cilat ngastra do të pyllëzohen, dhe pastaj të mos ndodhemi përballë eksperiencave të tjera siç është, për shembull, rasti i Përmetit apo ndonjë rast tjetër, i gjithë komuniteti është ngritur edhe ka filluar aty një konflikt midis investitorit edhe komunitetit. Prandaj do t’ju lutesha që gjërat të mos shikohen kaq teknikisht dhe duhet të ketë mirëkuptim edhe kur ka dyshime nga ana e ligjvënësit, pasi ka natyra të tilla pabarazie që janë të dukshme në ligj, edhe konflikte në mënyrën e të thënit të problemit. Ju vetë na thoni në nenin 4 që në ngastrat e përcaktuara, por kur thua “në ngastrat e përcaktuara” neni 3 do të kishte 1, 2, 3, 4, 5 ngastra.

Prandaj do t’ju lutesha që shpjegimet tuaja duhet të jenë shteruese. Me të drejtë zoti Xhafaj tha se ne nuk jemi komisioni përgjegjës, por ne jemi komisioni që vlerësojmë kushtetueshmërinë, barazinë para ligjit e kështu me radhë. Siç e keni formuluar, ju këtu ka një problem.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko!

Zoti Manja!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Në parim edhe unë jam dakord me projektligjin e ardhur, por dua të shpreh edhe unë shqetësimet në vazhden e shqetësimeve që kanë kolegët. Me thënë të drejtën kisha shumë pyetje në lidhje me këtë projektligj, por e rezervova të drejtën të them pak gjëra, lidhur me projektligjin që ju keni sjellë në formën e komenteve. Në fakt unë nuk e di se sa është numri i HEC-ve ose i kontratave koncesionare të dhëna në Shqipëri, qoftë i subjekteve vendase, qoftë edhe i subjekteve të huaja, por jam i bindur që me gjithë këto kontrata koncesionare që janë dhënë mbi fondin pyjor në Republikën e Shqipërisë kompanitë koncesionare kanë kryer dhe vazhdojnë të kryejnë masakër mjedisore. Unë e di se çdo subjekt që aplikon për të marrë një kontratë koncesionare për ndërtimin e një HEC-i, në letër, ka jo vetëm studim fizibiliteti, por jam i bindur që në ato dosjet e paraqitura qoftë te ministria e Energjetikës apo te Ministria e Mjedisit, ata kanë të përcaktuar edhe llojet e drurëve, të sipërfaqeve që do të mbillen. Pasi ka përfunduar ndërtimi i këtyre HEC-eve, nuk më rezulton që nga ana e Ministrisë së Mjedisit, e cila është përgjegjësjë kryesore për ruajtjen dhe zhvillimin e fondit pyjor dhe më pak nga Ministria e Energjetikës, të jenë rehabilituar sipërfaqet e fondit pyjor të dëmtuar nga ndërtimi i këtyre koncesioneve. Për këtë kam provë. Mjafton të shikohen HEC-et e ndërtuara në Lurë dhe në Selishtë, e gjithë infrastruktura që shkon deri te

nënstacionet, shtyllat, kanalet e cila është dëmtuar, nuk rezulton të jetë rehabilituar asnjë dru i dëmtuar në fondin pyjor. Lind pyetja, kush e mbikëqyr rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara në pyje, pasi koncesionarët dalin në prodhim dhe fillon prodhimin i energjisë?

Koncesionarin, për të cilin ju keni sjellë projektligjin sot, e falënderoj, sepse e shikoj se është serioz, përderisa kemi të bëjmë me një kompani të huaj, që jua ka kërkuar në formën e një ligji sipërfaqen e fondit pyjor që kërkon t'i vihet në dispozicion për ndërtimin e HEC-it. Koncesionarë shqiptarë jo vetëm që nuk kanë marrë masat për rehabilitimin e zonave, por ju e dini shumë mirë se ka të tillë që janë dentistë. Po të shikoni lejet që janë dhënë të HEC-eve, dihet se si janë dhënë dhe për çfarë janë dhënë. Nga vitet 2005-2015, të paktën në zonën time, e kam fjalën për qarkun e Dibrës, duke filluar nga HEC-et në kaskadën e Komsit, në Lurë, në Selishtë, në mal dhe në Bulqizë koncesionarët rezultojnë mësues, mjekë dhe dentistë që nuk kanë asnjë sensibilitet mbi ndjeshmërinë e dëmtimeve në fondin pyjor. Ju në këtë projekt që keni sjellë kërkonin heqjen nga fondi pyjor të rreth 600 hektarëve, ndërkohë që në nenin 4 thuhet se do të rehabilitohet dhe do të rivitalizohet një sipërfaqe prej 458, 73 hektarësh. I bie që 42,25 hektarë nuk do të rehabilitohen, nëse do të bëjmë një diferencë. Unë jam i bindur që interesi i shtetit shqiptar, përfitimet janë shumë më të mëdha në rastin e këtij HEC-i sesa dëmtimi i 42,25 hektarëve. Kush më garanton që për një periudhë 3-vjeçare, siç përcaktohet në projektligj apo 5-vjeçare siç u tha për në Devoll, do të ndodhë rehabilitimi i këtij fondi pyjor të dëmtuar nga Veriu në Jug, kudo ku ka ujë dhe po shfrytëzohet për HEC-et? Këtë përgjigje unë jam i bindur edhe sot edhe pas shumë kohëve, nuk do ta marr.

Shqetësimi tjetër që kam është se çfarë penaltitësh ka në kontratat e koncesionit në rast të mosrehabilitimit të fondit pyjor të dëmtuar? Ju shumë mirë mund të më thoni se penaltitetet do të përcaktohen në kontratën që do të nënshkruhet me koncesionarin dhe jo në projektligj. Ne i dimë penaltitetet e kontratave, në përgjithësi vendosen me koncesionarët, gjërat që ju mund të thoni se shkojnë në 3-4 dhe 5 fish, por kjo gjë nuk ma rikthen pyllin e dëmtuar mua si qytetar në Republikën e Shqipërisë. Nuk është e nevojshme që ju si dikaster, qoftë Ministria e Mjedisit, qoftë Ministria e Energjetikës, të vendosnit në kontratat dhe koncesionet apo qoftë edhe në këtë projekt që keni sjellë penaltite shumë më të ashpra, në rast të mosrehabilitimit të fondit pyjor, deri në mos daljen në treg të këtij koncesionari, në rast se nuk rehabilitohet fondi pyjor sipas atyre që përcaktohen në ligj?

Do t'ju lutesha që çështjet e mjedisit, ju t'i merrni me shumë seriozitet, sepse nëse ka një krim që ndoshta gradualisht po kryhet në Shqipëri, ajo që nuk duket ose nuk bën bujë është krimi mjedisor.

Në këtë kuptim, unë bashkohem me të gjitha shqetësimet e kolegëve të mi. Në parim e shprehja që në fillim se jam dakord. Për votën time në lidhje me këtë projektligj, rezervoj të drejtën të jem pjesëmarrës në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese si komisioni përgjegjës për votimin e këtij projektligji, ku duhet të marr një informacion më të saktë, më të detajuar se çfarë po ndodh në lidhje me dëmtimin e fondit pyjor nga ndërtimi i HEC-eve dhe cilat janë përfitimet dhe dëmet që i vijnë shtetit shqiptar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Besoj se këtu mbyllen diskutimet për këtë projektligj.

Të nderuar kolegë, unë e vlerësoj jashtëzakonisht përkushtimin dhe seriozitetin me të cilin jemi duke e trajtuar të gjithë së bashku shqyrtimin e këtij projektligji, sepse është një ndjeshmëri e lartë për qytetarët shqiptarë, nga specialistët dhe ekspertët e kësaj fushe. Nuk ka sesi të mos vijë e tillë edhe te ne si përfaqësues të qytetarëve të këtij vendi, si ligjvënës, për sa i përket vlerësimit që i duhet bërë mjedisit në tërësi dhe në mënyrë të veçantë sipërfaqeve pyjore që edhe aq sa janë sot, janë jo pak të degraduara dhe çdo shpërdorim i mëtejshëm i tyre do të sillte pasoja të pallogaritshme për ekosistemin dhe për të ardhmen mjedisore të këtij vendi. Është shumë e rëndësishme të ndërtosh një hidrocentral, të shtosh fuqitë energjetike të vendit, por kjo nuk duhet të rëndojë në prishjen e ekuilibrave natyrorë, jo thjesht nga pikëpamja vizive, por nga ajo e vlerave mjedisore aq të rëndësishme për vendin tonë.

Kjo gjë duhet të mirëkuptohet edhe nga përfaqësuesit e qeverisë, jo thjesht të mirëkuptohet, por duhet të reflektohet mbi këtë shqetësim të kolegëve të këtij komisioni, që shpreh nga ana tjetër edhe një premtim, angazhim publik të kësaj maxhorance gjatë kohës që ka qenë në opozitë dhe një përkushtim të veçantë që është duke shprehur gjatë gjithë kësaj periudhe qeverisjeje për një qasje tjetër ndaj mjedisit në vend.

Mbetem i shqetësuar për teknikën, kjo është dytësore, sepse primare është thelbi, substanca, pasoja që sjell ky ligj dhe vëmendja që duhet të tregohet për të administruar çdo lloj efekti negativ për të minimizuar apo për ta eliminuar nëse mundemi, por nga ana tjetër më duhet të them se edhe shqetësimi për të qenë më të përgjegjshëm me veprime, hapa të tillë qofshin ligjorë, duhet të jenë prezentë në projekte të kësaj natyre, sepse Kuvendi nuk është

zyrë kadastrë që do të bëjë thjesht një zhvendosje të pasurisë, por është më shumë sesa kaq. Kuvendi është përgjegjës dhe ligjvënësit kanë detyrimin, përgjegjësinë dhe të drejtën për të parë krahas politikave energjetike, edhe ato mjedisore për të bërë kontrollin e zbatimit të ligjit në vend.

Nga ana tjetër dua të them se më vjen keq edhe për teknikën legjislative. Ka të drejtë relatori, sikur nuk është shkruar nga juristë, por edhe sikur të jenë specialistë të fushës, janë disa gjëra që me pak kujdes mund të mos ishin kështu. Ne do t'i shikojmë nen për nen. Jemi dakord në parim.

Në votimin në tërësi mund të shpreheni për votën, pasi t'i kalojmë nen për nen, sepse është e drejtë e kolegëve.

Ka një abstenim paraprak nga disa kolegë, sepse do të shohim sesi do të pasqyrohen nen për nen.

Në parim miratohet.

Kalojmë te miratimi nen për nen.

Neni 1. Objekti.

Relatori ka propozuar që neni 1 të bashkohet me nenin 2 dhe të jetë një nen i vetëm. Mendoj se kjo është e justifikuar, sepse pika 1 e nenit 1 është pothuajse e ngjashme me nenin 2 të projektit.

Zoti Muçmataj, është propozimi juaj, i mbetenit atij?

Vexhi Muçmataj - Po.

Fatmir Xhafaj – Pika 3 e nenit 1, mendoj se është e panevojshme për sa kohë që te neni 3 përditësimi i regjistrave, është gati e njëjta gjë. Nuk e kuptoj pse duhet edhe këtu edhe atje. A mund të më thoni pse duhet pika 3 e nenit 1, kur keni nenin 3 që është përditësimi i regjistrave? Çfarë të reja thotë? Njëri nga këto duhet të qëndrojë apo jo?

Po, zoti

Ylli Hoxha - Me sa shikoj te pika 3 e nenit 1 është objekti dhe aty përmenden të gjithë hapat që duhet të ndiqen në këtë ligj.

Fatmir Xhafaj - Jo, jo sipas kësaj i bie të futësh të gjithë ligjin brenda. Është e njëjtë pika 3 me nenin 3 apo nuk e lexoni njëllë me mua?

Ylli Hoxha - Ndoshta përditësimi i regjistrave shtjellon më shumë rrugën që duhet të ndiqet, sepse kemi pyje ose fond pyjor me pronësi të ndryshme.

Fatmir Xhafaj - Po them se është e njëjta gjë në pikën 3 me nenin 3.

Ylli Hoxha - Jam dakord ta heqim pikën 3.

Fatmir Xhafaj – Po pse i bie vërdallë apo ngaqë është zgjeruar sheshi “Skënderbej”, dhe ti bën një xhiro. Bjeri shkurt për të shkuar te ministria.

Dakord është edhe ministria me propozimin e relatorit.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Muçmataj, bashkohet dhe bëhet një nen.

Ju keni dy nene 3. E kuptoni se çfarë projekti keni sjellë?

Keni neni 2, nenin 3 dhe përsëri nenin 3.

Dashamir Peza - Si do ta kaloni?

Fatmir Xhafaj - Do ta ndryshojmë, prandaj jemi këtu.

Po, zoti Muçmataj.

Vexhi Muçmataj - Kur mora fjalën në fillim e thashë se duhet të rishikohet edhe një herë ligji nen për nen.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Jemi dakord me propozimin e relatorit për ta ndërprerë këtu, me qëllim që t'i japim kohë atij për ta parë paraprakisht edhe një herë nen për nen, për të sqaruar detajet dhe për të sjellë reflektimet e kërkuara nga kolegët deputetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Marrëveshja të jetë pjesë integrale e tekstit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Hysi, marrëveshje është në të ardhmen dhe jo në të djeshmen.

Silleni edhe marrëveshjen për ta reflektuar.

Zoti Muçmataj, gjëja tjetër është nevoja për një kontroll periodik për zbatimin e këtij ligji. Duhet të bisedohet edhe me komisionin përgjegjës që ministria në mënyrë periodike të raportojë para komunitetit, bashkërisht me organet vendore dhe të informojë komisionin përkatës mbi zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Zotërinj të ministrisë, besoj se e kuptuat në mënyrë të veçantë ju të Ministrisë së Mjedisit, pasi ju jeni të kënaqur që i keni dhënë koncesionet dhe uroj që ato të bëhen dhe të mos kenë fatin e disa të tjerave që kanë nga 20 vjet që nuk po bëhen. Është mirë që ministria e ka shtrënguar këtë proces.

Do t'ju lutesha që edhe ju të bashkëpunoni me këtë pjesë. Në mënyrë të veçantë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, bashkë me relatorin të ulen për ta detajuar dhe për ta specifikuar përgjegjësinë e palëve dhe kontrollin.

Faleminderit!

Pasi e kemi miratuar në parim, nen për nen dhe në tërësi do ta shqyrtojmë një ditë tjetër.

Sekretar
Armando Subashi

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 11.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për shfuqizimin e ligjit nr. 10168, datë 22.10.2009 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG, sh.a”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Tom Doshi

Të ftuar:

Ervin Mete- zëvendësministër në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj- Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Të ftuar në komision janë: zoti Ervin Mete, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, së bashku me zotin Hoxhaj, drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, pra kolegu ynë Hoxhaj, që do ta përfaqësoni, apo jo? Është e mjaftueshme. Po. Faleminderit!

Atëherë një prezantim të shkurtër nga zoti Mete, meqenëse projekti është edhe i njohur për kolegët, sepse e kanë përpara edhe projektligjin, edhe relacionin. Relatori, zoti Subashi dhe kolegët.

Ervin Mete – Faleminderit, zoti kryetar!

Shkurtimisht, projektligji që propozohet s'mund të shfuqizojë një ligj që ka dalë për privatizimin e INSIG-ut në kohën kur INSIG-u konsiderohej sektor strategjik. Që prej 2009-ës, në ligjin e sektorëve strategjikë, sektori i sigurimeve nuk konsiderohet si i tillë. Pra do t'i nënshtrohet procedurave normale të privatizimit. Ne jemi në një proces që po përgatisim një përpjekje për privatizimin e INSIG-ut, dhe ligji aktual që e trajton si sektor strategjik, nuk është në linjë me ligjin për sektorët strategjikë, ndaj kërkojmë shfuqizimin e këtij ligji, në mënyrë që t'i hapet rruga privatizimit normal. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Mete!

(Diskutim pa mikrofon)

Aq është edhe ligji, në fakt, po ashtu relacioni është i qartë. Edhe unë i kërkoja një gjë të shkurtër.

Të flasë relatori!

Armando Subashi – Në fakt, drafti që ka ardhur – është e vërtetë – ka vetëm një nen, dhe neni që ka ligji është pikërisht neni që kërkon shfuqizimin e një ligji të miratuar në 2009-ën. Edhe ai ligj që kërkohet të shfuqizohet është një ligj i shkurtër, me disa nene, i cili ka parashikuar në mënyrë shumë të përmbledhur disa modalitete konkrete se si do të bëhej privatizimi i kësaj kompanie shtetërore.

Ndoshta për ta bërë pak më të qartë për publikun, situata është e tillë: në vitin 1996 është miratuar një ligj për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë, dhe në nenin 4 të atij ligji, pra të ligjit të 96-ës, veç të tjerave parashikohet që sektorë me rëndësi të

veçantë të ekonomisë, kuptohen industria e energjetikës, e mineraleve, e naftës, e gazit, postat, telekomunikacionet, pyjet, ujërat, rrugët, hekurudhore, automobilistike, porte detare, aeroporte, transporti ajror e hekurudhor, si dhe sektori i bankave të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror dhe shoqëritë e sigurimeve me kapital tërësisht shtetëror.

Pra, ky është ligji i 96-ës.

Në vitin 2009, më 15 tetor të 2009-ës, këtij ligji, pra ligjit të 96-ës, i janë bërë disa ndryshime, do të thosha unë, referuar edhe një ligji tjetër të 08-ës, ku pikërisht fjalja e fundit, pra “Sektori i bankave të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror dhe shoqëritë e sigurimeve me kapital tërësisht shtetëror” janë hequr, dhe që nga ai moment, pra që nga 2009-a, nuk janë konsideruar më sektorë me rëndësi të veçantë në ekonomi. Pak më vonë, ajo që në fakt është edhe për t’u çuditur pak, është se një javë pasi është bërë ky ndryshim, pikërisht më datën 22, në mos gabo, më 22 tetor, është miratuar një ligj specifik për përcaktimin e formulës dhe të formës së privatizimit të INSIG-ut.

Në fakt, sipas pikëpamjes time, që në momentin që është miratuar ky ligj, ka qenë totalisht i panevojshëm, sepse, imagjinoni, një javë më përpara se të miratohej ky ligj, pra më 10 tetor, më 15 tetor, më falni, INSIG-u është hequr nga lista e sektorëve strategjikë. Nga kjo pikëpamje, duke u hequr, ai i nënshtrohet privatizimit si të gjithë sektorët e tjerë, sipas rregullave të përgjithshme dhe ligjit të bazë që ekziston në Shqipëri për privatizimin e sektorëve e ndërmarrjeve shtetërore. Një javë pasi është hequr si sektor strategjik, është miratuar një ligj i posaçëm, i cili edhe ai, po ta merrni e ta lexoni, nuk është se thotë ndonjë gjë apo përcakton ndonjë gjë specifike për mënyrën se si do të bëhet privatizimi i INSIG-ut.

Kështu që, nga kjo pikëpamje, unë do të thosha se ligji që vjen sot, i cili është thjesht e vetëm me një nen, ku parashikon shfuqizimin e ligjit 10. 168, datë 22. 10. 2009, besoj se nuk përbën ndonjë problem, si nga pikëpamja kushtetuese, ashtu edhe nga pikëpamja ligjore. Pyetja që shtrohet në këtë rast, me të drejtë, dhe që besoj, këtu do të doja ndoshta ndonjë opinion të shkurtër nga përfaqësuesit e Ministrisë, është pikërisht kjo, që: me shfuqizimin e këtij ligji, i cili realisht është i shkurtër si ligj dhe nuk është se na jep ndonjë gjë të veçantë për mënyrën se si do të privatizohet INSIG-u. A është i mjaftueshëm ligji bazë, që ne kemi për privatizimet në Shqipëri, për të bërë të mundur përmbushjen me sukses të privatizimit të kësaj kompanie shtetërore? Nëse në atë ligj ne mendojmë dhe jemi të bindur se janë të përcaktuara të gjitha modalitetet se si do të bëhet privatizimi i kësaj kompanie, atëherë, besoj, nuk duhet të kemi asnjë shqetësim. Në rast të kundërt, nëse ligji bazë nuk përcakton ose nuk na kënaq në pritshmërinë që ne kemi në raport me privatizimin e kësaj kompanie, sigurisht që

këtu pastaj ka vend që të mendonim të gjithë se si mund ta përsosnim më mirë procedurën, modalitetet, mënyrën e privatizimit të kësaj kompanie, e kështu me radhë.

Unë besoj se, përderisa qeveria ka gjykuar që ky ligj nuk sjell ndonjë gjë të re, përkundrazi do t'i hapë më mirë rrugën privatizimit të kësaj kompanie, besoj se edhe këtë merak që mund të kemi e zgjidh ligji bazë dhe ajo çka kemi sot në fuqi në raport me privatizimin e sektorëve shtetërorë.

Kështu që, përfundimisht do të thosha se, nga pikëpamja kushtetuese drafti i ardhur nuk sjell ndonjë implikim, por as nga pikëpamja ligjore besoj se nuk krijon ndonjë problem. Kështu, unë do t'i ftoj kolegët për t'i miratuar. Pastaj, sigurisht, kur të vijmë te neni 1, se një nen ka, pa dyshim që mundet të bëjmë ndonjë ndryshim, më shumë për sa i përket teknikës legislative, se sa thelbit të vetë ligjit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Subashi!

Ka pyetje?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – E para, unë jam dakord me relatorin. E sqaroi pak më në detaje, por unë do të pyesja se, përse në vitin 2000 është quajtur një privatizim strategjik dhe nuk është kryer, dhe këtë duhej të na e thoshte Ministria e Ekonomisë, një gjë e cila është bërë këtu e 16 vjet më përpara; ka ngelur prapë si sektor strategjik, dhe sot ne ndërmarrim veprimin për ta hequr nga një sektor strategjik privatizimin e tij.

Dua të di çfarë do të thotë kjo, kur e heq nga një sektor i privatizimit strategjik? Çfarë ndodh, domethënë, me vlerën e kësaj kompanie?

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit!

Zoti Mete, ju lutem!

Ervin Mete – Faleminderit, zoti kryetar!

Atëherë, sa i përket tentativës së 2009-ës, pasi ka kaluar ky ligj, ka nisur një proces privatizimi, është kontraktuar një konsulent, siç e kërkonte edhe ligji, por që nuk kanë përsormuar. Në momentin që ne e kemi gjetur kompaninë, kemi vënë në dukje këtë mosperformancë të konsulentit, kemi shkuar në gjykatë, kemi fituar shkallën e parë, dhe tashmë çështja është në apel. Pra, procesi nuk ka qenë i suksesshëm. Deri më 2009-ën – sepse ka pasur edhe procese të më pasme – është trajtuar si sektor strategjik edhe për shkak të rëndësisë dhe peshës që ka pasur në treg, sepse të kemi parasysh se dikur ka qenë dominonte, pastaj ka qenë një pjesëmarrje domethënëse, ndërsa tani është një pjesëmarrje

modeste, që varion, po themi, nga 3% në Maqedoni, diku te 5-6% në Kosovë, në një kohë që Shqipëria varion ndërmjet këtyre të dyjave, diku te 4. 5 ose 5%.

Pra, kjo është, si ët thuash, pjesëmarrja në treg e kompanisë. Çfarë do të thotë që në 2009-ën është nxjerrë nga sektorët strategjikë?

Do të thotë se për privatizimin nuk nevojitet një ligj i veçantë, siç është ky ligj, por ndjek rrugën normale të privatizimit, e cila konsiston së pari në një urdhër të ministrit të Ekonomisë, si përfaqësues i pronës shtetërore. Në fakt, kur janë sjellë në Kuvend, janë sjellë dy akte, pra ky shoqërohet me një akt tjetër, që e kalon ministrin e Ekonomisë si përfaqësues të pronës. Pastaj ndërmerret një proces vlerësimi nga një kompani konsulente. Në fund përfundon në ankand. Pra, privatizimet e aksioneve të shoqërive shtetërore ndodhin e kanë ndodhur edhe gjatë kësaj kohe, kështu që baza ligjore është e qartë për ta trajtuar si një privatizim normal.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi, pyetje?

Vasilika Hysi – Po, pyetje.

Kam një pyetje lidhur me pikën 2 të relacionit. Ju në relacion thoni se ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik e të Sipërmarrjes, ndërkohë që ne na vjen në parlament. Cila është arsyeja, që ka ndryshuar prapë prioriteti, megjithëse nuk shtë përfshirë në programin analitik të akteve e të dokumenteve të tjerë politikë, tashmë ne e kemi që në fillim të vitit në tavolinë?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – faleminderit, zonja Hysi!

Zoti zëvendësministër, fjala për ju.

Ervin Mete – Kjo është në përputhje me kohën kur është marrë vendimi nga qeveria, për të shkuar drejt privatizimit. Është analizuar situata ligjore, dhe pas saj është përcjellë akti në parlament.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Diskutime? Nuk ka.

Relatori, përpara se të votojmë në parim, dëshiron të sqarojë ndonjë gjë? Ke nevojë?

Armando Subashi – Unë ngrita një shqetësim, por edhe zoti Fino, për pyetjen që bëri. Në fakt, besoj se zëvendësministri i sqaroi të dyja momentet. Pra, së pari tha se ligji

bazë që ne kemi për privatizimin nuk krijon ndonjë problem dhe mbi bazën e tij mund të bëhet me sukses privatizimi i INSIG-ut. Së dyti, u sqarua edhe fakti se heqja si sektor strategjik nuk është bërë tani, por është bërë më 2009. Unë e thashë edhe në relacion që, në fakt atëherë ka ndodhur një absurditet, por sigurisht që ndoshta kjo është një tregues tjetër për mënyrën se si i bënte punët Saliu, që më 15 tetor e heq INSIG-un si sektor strategjik, ndërsa pas një jave miraton një ligj për mënyrën e privatizimit, duke e konceptuar dhe duke e menduar si sektor strategjik. Në fakt që në kohën kur është miratuar ky ligj që ne kërkojmë ta shfuqizojmë sot, ka qenë i panevojshëm dhe i pakuptimtë.

Ashtu siç e tha edhe zëvendësministri, vetë gjithë këto vite, në fakt, treguan më së miri se ai ligj nuk ka vlejtur dhe nuk i ka shërbyer realisht privatizimit me sukses të kësaj kompanie,

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Faleminderit!

Me sa duket gjëja është e qartë. Dakord jemi, në parim?

(Diskutime pa mikrofon)

Në parim, dakord jeni, kolegë? Dakord jeni.

Faleminderit!

Neni 1? Dakord.

Armando Subashi – Unë kam diçka te neni 1.

Fatmir Xhafaj – Po. Ju lutem, zoti zëvendësministër, ndiqeni relatorin.

Armando Subashi – Në pjesën e fundit të fjalisë, që thotë: të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Në fakt, nuk mund ta themi këtë, por, nga një bisedë që kam pasur, ideja e kësaj shprehjeje, në fakt, është që jo vetëm të shfuqizohet ligji, por ndoshta edhe aktet nënligjore që mund të kenë dalë në zbatim të tij. Kjo ishte ideja, sepse nuk bëhet fjalë për ndonjë ligj tjetër apo ndonjë dispozitë të ndonjë ligji tjetër që duhet të shfuqizohet. Mbi këtë bazë dua të bëjmë një korrigjim këtu: të ndryshuar, si dhe çdo akt i nxjerrë në zbatim të tij.

Besoj se kjo na heq çdo lloj problemi që mund të krijohet. Kjo është e vetmja ndërhyrje që kam.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Faleminderit!

Jeni dakord? Me mikrofon, ju lutem! Zoti zëvendësministër?

Ervin Mete – Po, dakord!

Fatmir Xhafaj – Atëherë, biem dakord me nenin 1, me shtesën e bërë? Me ndryshimin? Po, dakord. Miratohet.

Neni 2. Dakord, në tërësi? Dakord. Faleminderit!

Miratohet me ndryshimet e bëra.

Dhjetë minuta pushim.

MBLEDHJA MBYLLET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 11.03.2015, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr 10019, datë 29.12.2008, i ndryshur me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012”
2. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë””

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë: Tom Doshi

Të ftuar:

Lefterie Luzi - kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Skënder Vrioni - sekretar i Pergjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Dëshira Pasko - drejtore e Drejtorisë Juridike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Petrit Gjokutaj - drejtor në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Alenka Verbole - përfaqësuese nga OSBE-ja
 Florian Hobdari - përfaqësues nga OSBE-ja
 Astrit Brasha - përfaqësues nga OSBE-ja
 Ermjona Gjyla - përfaqësuese nga Këshilli i Europës
 Ana Kadovic - drejtoreshë e Institutit Demokratik Kombëtar
 Armela Prevazi- oficerë programi e Institutit Demokratik Kombëtar
 Gerta Meta - drejtoreshë ekzekutive në Shoqatën për Kulturë Demokratike
 Rajmonda Prifti - drejtoreshë ekzekutive në Shoqatën për Gratë dhe Fëmijët
 Premto Gogo - president e KRIIK Albania Association
 Blerta Balili - përfaqësuese e Womens Democracy Network-Shqipëri
 Ines Leskaj - përfaqësuese AWEN-Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
 Blerina Metaj - Bruna Hylviu – përfaqësuese nga Koalicioni për Pjesëmarrjen e Grave dhe të Rinjve në Politikë
 Edlira Çepani - përfaqësuese e Rrjetit të Grave “Barazi në Vendimmarrje”

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e komisionit, meqenëse kuorumi është i realizuar.

Në këtë mbledhje të veçantë të komisionit të posaçëm kemi për shqyrtim dy projektligje që janë të fokusuar në ndryshimin e të njëjtit ligj të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008.

Fillimisht, të dyja janë iniciativa të deputetëve, me ndryshimin se iniciativa e një grupi deputetësh të këtij komisioni është e iniciuar ose e ndërtuar mbi bazën e një kërkesë të sjellë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të reflektuar ndryshimet, ndër të tjera edhe ndryshimet e bëra në reformën zgjedhore. Për këtë arsye në këtë mbledhje sot është thirrur të jetë e pranishme, kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zonja Lefterie Luzi, së bashku me ekipin mbështetës, stafin teknik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtorin e Drejtorisë Juridike dhe drejtorin e Teknologjisë së Informacionit, për t'iu përgjigjur pyetjeve të mundshme, nëse do të ketë të tilla nga deputetët.

Faleminderit!

Janë të pranishëm edhe një grup kolegesh deputete, të cilat janë në mbështetje të nismës së një grupi deputetesh, të cilat i përfaqëson këtu zonja Hafizi dhe zonja Caka, që janë nënshkruese të projektit.

Koleget deputete që kanë ardhur për të lobuar e mbështetur iniciativën e kolegeve të tyre, kanë të drejtën, sipas Rregullores, të jenë të pranishme, kanë të drejtën e fjalës, nëse do ta çmojnë të nevojshme, por nuk kanë të drejtën votës.

Do të fillojmë me projektin e parë, që është ai i paraqitur nga deputetët Blendi Klosi, Ulsi Manja, Vehxhi Muçmata dhe Petrit Vasili.

A dëshirojnë deputetët që kanë nënshkruar iniciativën të thonë diçka më shumë për projektin?

Dakord.

Zonja kryetare, meqenëse edhe iniciativa e kolegëve deputetë është mbështetur në kërkesën e komisionit që drejtoni ju, besoj do të jetë i nevojshëm një sqarim për deputetët edhe për median gjithashtu.

Po, zonja Luzi.

Lefterie Luzi – Faleminderit, zoti kryetar i komisionit!

Faleminderit edhe grupit nismëtar në lidhje me draftin, të cilin ne e kemi përpara!

Ne jemi njohur me draftin e deputetëve të nderuar dje, njëkohësisht kemi marrë edhe njoftimin për mbledhjen për të ardhur dhe për të dhënë mendimet tona. Kemi punuar dje dhe duam të nënvizojmë faktin që jemi involvuar paraprakisht në lidhje me ndryshimet në Kodin Zgjedhor, që kanë të bëjnë me reflektimin e ndryshimeve që i bëhen ligjit për reformën administrative- territoriale nëpërmjet ministrit Çuçi, pasi ai i ka kërkuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mendime në lidhje me reflektimet në Kodin Zgjedhor. Dhe janë këto mendime që ne i kemi paraqitur dhe ia kemi sjellë edhe Kuvendit.

Gjithsesi, ne sot kemi punuar mbi draftin, e deputetëve të nderuar. I falënderojmë shumë, sepse, në fakt, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë të planit të orientimit, duhej të kishte kaluar një sërë aktesh, të cilat nuk i ka kaluar dot vetëm për shkak të ndryshimit të ligjit “Për reformën administrative- territoriale”, i cili normalisht dhe ligjërisht duhet patjetër të reflektohej në Kodin Zgjedhor.

Ne i kemi bërë reflektimet tona të këtij drafti nen për nen. Nëse duam të ecim nen për nen, ne jua themi mendimet tona të përcaktuara për çdo nen. Vlen për ta bërë këtë, sepse janë gjërat teknike për t’u reflektuar.

Gjithsesi, ne i kemi përgatitur edhe me shkrim për t’ia paraqitur komisionit. Në lidhje me draftin e paraqitur nga deputetët e nderuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve reflektoi ndryshime të tilla: në pjesën më të madhe të draftit rezulton se është pasqyruar korrektësisht ndryshimi i ligjit për reformën territoriale në Kodin Zgjedhor, por ka disa nene, të cilat edhe këto nga pikëpamja teknike duhen reflektuar. Konkretisht duhen bërë ndryshime, përveç atyre të paraqitura, në nenin 48 të ligjit, duhen bërë ndryshime në nenin 67, këto nuk janë paraqitur në draft, këto janë propozimet tona, duhen bërë ndryshime në nenin 94, në nenin 97, në nenin 104, në nenin 116 dhe në nenin 120. Këto janë nene të cilat komisioni duhet t’i marrë në konsideratë për të bërë ndryshimet e nevojshme, përpos atyre, të cilave ju i keni bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Meqenëse krahas këtyre dispozitave, amendamenteve të paraqitura nga kolegët deputetë, ju parashtroni nevojën e disa ndryshimeve të tjera të teknike, të domosdoshme për normalitetin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve?

Lefterie Luzi – Po.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ajo që do të duhet të bëni është që t'i shpjegoni këtij komisioni se ku konsistojnë këto rregullime të kërkuara nga ana juaj dhe çfarë pasojash do të sillnin nëse nuk do të miratoheshin me këto ndryshime, sepse ne do të duhet të kalojmë ndryshimet më të rëndësishme që janë për efekt të normalitetit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vetëm për përgatitjen e zgjedhjeve vendore dhe ato amendamente, të cilat, nëse nuk do të realizoheshin, do ta pengonin normalitetin e këtij procesi. Nuk duam të bëjmë miratime të tjera, sepse Kodi Zgjedhor mund të ketë nevojë për shumë ndryshime të tjera, por nuk është misioni dhe qëllimi që i ka vënë vetes Komisioni i Ligjeve, përkundrazi ai ka marrë përsipër ta bëjë këtë, duke u mbështetur edhe në nevojën që lind nga rregullimi i ri i hartës territoriale dhe pasojat që krijon ajo, edhe për efekt të procesit zgjedhor, por edhe për efekt të normalitetit të punës, bazuar në atë çfarë ju keni parashtruar në disa kërkesa të njëpasnjëshme, ju si Komision Qendror i Zgjedhjeve, por më së fundi edhe organizata të shoqërisë civile, që monitorojnë procesin zgjedhor në Shqipëri të cilat, gjithashtu, janë ftuar sot të jenë të pranishme për të ndjekur seancën dhe për t'u dëgjuar.

Po, zonja kryetare.

Lefterie Luzi – Faleminderit!

Pikërisht, është kjo arsyeja dhe fokusi i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të realizuar zgjedhjet e ardhshme dhe për të reflektuar vetëm teknikisht ndryshimet që vijnë si pasojë e ligjit “Për reformën administrative- territoriale”.

Tri janë kriteret:

E para, është kriteri për ngritjen e ZAZ-ve, për ndarjen e re të tyre.

E dyta, është statusi i Bashkisë së Tiranës, i cili duhet reflektuar patjetër në këtë draft që kemi sot. Në nenet që ne kemi shtuar është pikërisht kjo më shumë, statusi i Bashkisë së Tiranës, i cili tani ndryshon me ligjin për ndarjen e re administrative

Dhe listat e zgjedhësve.

Këto kanë qenë tri arsyet kryesore, ku jemi fokusuar ne për ndryshimet në nenet që kemi paraqitur. Sigurisht, kemi kërkuar te dispozitat kalimtare për faktin se ne e kemi kaluar kohën e paraqitjes së kandidatëve për anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit

Zgjedhor dhe kohën e konstituimit të tyre, kemi paraqitur para jush edhe një dispozitë kalimtare të cilën e kemi paraqitur me variante dhe kërkojmë para këtij komisioni ose t'i japë autoritetin Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që vetë komisioni me akt të ndërmarrë një gjë të tillë dhe në këtë akt ai të pasqyrojë afatet e tjera kohore, sepse ne nuk dimë edhe kur do të hyjë ligji në fuqi. Përveç këtyre dy akteve që përmenda, ndryshimi i afateve kohore të nxjerrjes së akteve, mund të reflektohet edhe në akte të tjera, të cilat kanë lidhje sigurisht vetëm me KZAZ-në.

Pra, fokusi i punës sonë ka qenë vetëm që ne të arrijmë të realizojmë këto zgjedhje dhe vetëm me ato kriteret që përmenda më lart dhe vetëm me ligjin për ndarjen e re administrative- territoriale. Kjo është në përgjithësi.

Edhe diçka tjetër, që është për t'u diskutuar, është se ndryshon pak nga rrjedha tjetër logjike, ka të bëjë me nenin 48 të ligjit dhe me listën e zgjedhësve, është një gjë që nga pikëpamja teknike duhet ta sqarojmë.

Fatmir Xhafaj – Po, mund ta sqaroni. Kush do ta sqarojë? Po, drejtori.

Petrir Gjokutaj – Faleminderit!

Në nenin 48 përcaktohen dy gjëra që kanë të bëjnë me listën e zgjedhësve.

Së pari, është formati i listës së zgjedhësve që afishohet, qoftë për të njoftuar zgjedhësit, është thjesht një element i vogël teknik që, duke qenë se në ligjin për ndarjen administrative-territoriale është futur koncepti i njësisë administrative dhe për faktin që në relacionin që shoqëron këtë ligj është theksuar që shërbimi i gjendjes civile do të vazhdojë të ekzistojë në njësitë administrative, ne mendojmë që në këtë listë duhet të vihet dhe njësia administrative. Aktualisht, neni 48, pika 1, thekson që duhet të jetë zona zgjedhore. Zona zgjedhore, kuptohet, për zgjedhjet për Kuvendin është qarku, për zgjedhjet vendore është bashkia. Ne mendojmë që të jetë zona zgjedhore, të jetë dhe njësia administrative. Kjo për faktin se veçanërisht për këto zgjedhje, duke qenë se funksionet për administrimin e listës së zgjedhësve po i kryejnë kryetarët e njësive të qeverisjes vendore aktuale, që janë në bashki dhe komuna, që me ligjin e ri të ndarjes territoriale marrin termin “Njësi administrative”, duhet ta gjejnë të reflektuar në këtë format veten e tyre. Kjo është e para.

E dyta, ka të bëjë po në nenin 48, ligji aktual përcakton që komisioni i administrimit zgjedhor lokal duhet të marrë tre formate të listës së zgjedhësve, një format që e publikon për zgjedhësit, një format që e përdor komisioni i qendrës së votimit, ku janë përcaktuar për të dyja elementët që duhet të përmbajë, dhe një format, thotë ligji, në rang zone zgjedhore, ku të jenë renditur zgjedhësit sipas rendit alfabetik të mbiemrit. Mendoni ndarjen aktuale. Zona

zgjedhore tani do të jetë bashkia, po të marrim vetëm zgjedhjet vendore. Ne mendojmë të bëhet një përcaktim jo në zonën zgjedhore, por në zonën e administrimit zgjedhor, dhe për faktin që do të kemi zona të administrimit zgjedhor, ku lista e zgjedhësve për njësi administrative do të bëhet nga zyra të ndryshme të gjendjes civile, këtë nuk duhet ta prodhojë kryetari, siç e ka ligji, pra kryetari t'ia çojë, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, por këtë duhet ta prodhojë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile që e ka këtë mundësi, sepse administrojnë bazën e të dhënave të të gjithë zgjedhësve të asaj zone të administrimit zgjedhor, ndërsa kryetari administrojnë vetëm listën e njësisë administrative që zyra e tij drejton.

Këto janë për sa i përket nenit 48.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka ndonjë gjë tjetër nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të parashtruar?

Po, zonja Luzi, urdhëroni!

Lefterie Luzi – Do të reflektoja vetëm nënet të cilat ne kemi shtuar, sepse pjesa tjetër është e ditur tashmë.

Atëherë, përveç nenit 48, që thamë që është komplet një nen i ri, që ne mendojmë të shtohet që të mos pengohemi në punën tonë nga sot edhe tutje, kemi shtuar dhe nenin 67, të cilin mendojmë që pikën 3 të këtij neni ta riformulojmë duke pasur parasysh këtu bashkinë Tiranë, vetëm për këtë efekt. E kemi riformuluar. Në qoftë se doni ta themi nenin, e themi.

Për faktin se Tirana me ligjin e ri ka pasur status të njëjtë me bashkitë e tjera dhe nuk duhet veçuar. Vetëm për këtë ne e kemi bërë këtë. Ky është qëllimi. Dhe nenin e kemi reflektuar në mënyrë të tillë: “Në zbatim të paragrafit të dytë, pikës 1 dhe paragrafit të dytë, pikës 2 të këtij neni, kandidati për kryetar bashkie dhe listat për këshillin vendor të njësisë të qeverisjes vendore, territori i të cilave nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, regjistrohen në KQZ”. E thashë edhe një herë, qëllimi është vetëm se Tirana me ligjin e ri ka një status të veçantë, ka një status të njëjtë me bashkitë e tjera dhe nuk duhet veçuar.

Kemi shtuar një nen tjetër, që ka të bëjë me nenin 94. Ne themi që kemi shtuar një nen, në kuptimin e nenit në draft. Në fakt, kemi riparë nenin 94, një pikë, pikën 2. Në nenin 94 ne kemi problemin e vendnumërimit të votave, të cilat me ligjin aktual kemi jo më pak se 5 dhe deri në 10 tavolina. Në fakt, nga ndryshimet e reja, në një ZAZ do të ketë ose një bashki, ose një pjesë e saj, që do të thotë, mund të kemi dhe bashki me pak qendra votimi, siç është rasti për shembull, i Pusecit, me 8 qendra votimi, Libohova me 12. Ne duam të ulim limitin e qendrave të votimit në vendnumërim jo nga 5 deri në 10, por të jetë nga 3 deri në

10. Jo maksimalen, por të lëvizim me minimalen, sepse mund të kemi zona të tilla të cilat mund të kenë pak qendra votimi, dhe kur nuk i kemi 5, ku t'i çojmë. Kështu që të ulim vetëm minimalen, ndërsa maksimalja të jetë 10 tavolina numërimi.

Kemi pikën 3 të nenit 97 ta shfuqizojmë dhe 3/1 bëhet 3. Pra, kemi elemente të tjera.

Por ajo të cilën ne e kemi ndryshuar, bëhet fjalë për nenin 120, ku për zgjedhjet e programit të pushtetit vendor KZAZ i vendos kutitë e votimit të grupuara sipas organit përkatës dhe pika 2, "Për çdo njësi të qeverisjes vendore numërimi fillon me votat për kryetarin dhe më pas vijon me numërimin e votave për këshillin përkatës.

Edhe në nenin 122, të njëjtin ndryshim kemi bërë, kemi bërë prapë reflektimin e bashkisë Tiranë. Unë i thashë që në fillim arsyet për të cilat ne kemi bërë ndryshime.

Ajo që ne kemi kërkuar, e kemi te dispozitat kalimtare nenet 180 dhe 181. Kemi problemin e afateve kohore, që i përcaktova në fillim, për të cilat ne kemi bërë dy variante. Neni 184, paragrafi i parë kërkojmë njërën nga këto dy variante, e lëmë në dorën tuaj të vendosni se kë konkretisht ju do të kaloni.

E para ka të bëjë me, përjashtimisht, themi, zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015, afatet e parashikuara në nenet 28 dhe 29 të Kodit Zgjedhor, të cilat nuk mund të zbatohen, ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për miratimin e tyre me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Kurse variantin e dytë e kemi që ngritja e komisioneve të administrimit zgjedhor, vendimi për ngritjen e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor merret nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve jo më vonë se 10 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe partitë politike propozojnë kandidaturat përkatëse për anëtarë të KZAZ-së menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Pra, e kemi bërë me dy variante, një variant që ju të autorizoni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në zbatim të afateve kohore të parashikuara nga nenet 28 dhe 29, që ne me vendim t'i përcaktojmë këto afate, ose ju me variantin e dytë përcaktoni afatin jo më vonë se 10 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sepse na ka ikur afati i dorëzimit të propozimeve për kandidatët e komisionit të zonave të administrimit zgjedhor.

Vendosni ju për kë mendoni, për ne nuk ka problem.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj nuk keni gjë tjetër e mbyllim këtu.

Lefterie Luzi – Në lidhje me këtë draft, jo.

Fatmir Xhafaj – Propozimi im është që të procedojmë, të dëgjojmë edhe iniciativën tjetër në mënyrë që të kur të formuloni pyetjet, të kemi mundësi, vetëm do t'i adresoni për

grupin nismëtar të dy iniciativat, t'i ndani pyetjet, ndërkohë edhe relatori, pasi të dëgjojë të dy grupet, të shprehet. Dakord.

Zonja Hafizi, ju do ta përfaqësoni?

Mimoza Hafizi – Po.

Fatmir Xhafaj - Pas zonjës Hafizi e ka kërkuar fjalën edhe zonja Caka për një ndërhyrje.

Mimoza Hafizi – Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Po prezantoj ndryshimet që ne propozojmë në Kodin Zgjedhor “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor”, kërkuar në emrin e Aleancës sonë të Grave Deputete.

Së pari, ndryshimet dhe shtesat që ne propozojmë shkojnë në linjën e deritanishme gjinore të Kodit Zgjedhor, të nisur që në vitin 2008. Është linja e kuotës, pra limiti i fiksuar i përfaqësimit të secilës gjini në listat e kandidatëve të partive apo koalicioneve, nën të cilin lista është e dënueshme nën këtë limit. Ky limit në vitin 2008 u fiksua në 30%, ai e rriti pjesëmarrjen e grave në parlament nga 7% në vitin 2005, në rreth 17% në vitin 2009 e më pas në vitin 2013. Me ndryshimet e reja ne po kërkojmë që kuota të shkojë në 40%, me qëllim që t'i afrohem nivelit 30% të pjesëmarrjes reale, qoftë në këshillat e ardhshëm bashkiakë, qoftë në parlamentin e ardhshëm.

Së dyti, ne po vijojmë gjithashtu të ruajmë frymën e ndryshimeve të vitit 2008, ku ka një përpjekje të parë për barazi shpërndarje të grave në lista. Në Kodin aktual kërkohet që ndër tri emrat e parë të listës së paraqitur nga partitë apo koalicionet, duhet t'i përkasë secilës gjini. Me ndryshimet tona ne kërkojmë që në secilin nga tri emrat e njëpasnjëshëm të listës, njëri duhet t'i përkasë secilës gjini, është fjala për gra.

Së treti, sanksioni i mosplotësimit të kërkesave gjinore të ligjit aktual, është gjoba. Ne kërkojmë që gjobat të zëvendësohet me refuzim të listës. Vënia e gjobës në vitin 2008 ka krijuar shtigje që nenet gjinore të ligjit të mos respektohen dhe objekti i ligjit të humbasë. U bë një rregullim në vitin 2012 përmes një neni artific, që vepron në rastet e dorëheqjes së deputetëve, pra mandateve të ndërprera. Ky rregullim, në fakt, na e rriti numrin e deputeteve gra me katër dhe e çoi përqindjen në 20,7%, që është aktualja në parlamentin tonë. Por kjo artificë krijoi disa anomali para elektoratit, të cilit ne nuk ia respektoam renditjen e kandidatëve në radhën me të cilën u paraqitëm në fushatë. Me nenin tonë të refuzimit të listës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për partitë apo koalicionet edhe kjo artific, pra ky nen bie poshtë.

Së fundi, për herë të parë po bëjmë një përpjekje për përfaqësim të rëndësishëm të grave edhe në përballjen mazhoritare për kryetar bashkish. Vendosëm një limit 20%, që duket shumë i ulët, por është një hap i konsiderueshëm, krahasuar me nivelin aktual, ku vetëm 4 gra kryetare ka në rreth 400 komunat, bashkitë dhe minibashkitë aktuale të Shqipërisë.

Këto janë ndryshimet kryesore të ligjit. Unë desha të ndaj me ju edhe përgjigjet e disa pyetjeve apo objekteve debati, që kemi pasur edhe në periudha lobimi, edhe brenda Aleancës sonë për të mbrojtur ndryshimet që ne propozojmë.

Pyetja e parë ka qenë: pse i propozojmë këto ndryshime?

Ne i propozojmë se besojmë që gratë shqiptare janë të nënpërfaqësuara në politikë në raport me cilësitë që ato mbartin. Sot në universitete mësojnë rreth dyfish vajza më shumë sesa djem. Sot fushat e talentit shkencor e artistik janë të pushtuar nga vajzat njëlloj si edhe nga djemtë. Sot qeveria ka më shumë se 35% ministre, të cilat po ia dalin njëlloj si burrat të mbajnë ngarkesa të rëndësishme qeveritare, pa llogaritur numrin e grave në nivelet e larta të administratës. Pse jo pra në parlament, pse jo në këshillat bashkiakë, pse jo në kryesimin e bashkive.

Së dyti, ne jemi vendi me nivel më të ulët përfaqësimi të grave në parlamente dhe në këshilla në rajon, përveç Malit të Zi. Sllovenia është 36%, Serbia 34%, Maqedonia 33,3%, Kosova 30% dhe vijnë vendet e tjera me radhë, të cilat, në fakt, kanë sisteme të ndryshme zgjedhore nga yni. Sistemet proporcionale si i yni favorizojnë pjesëmarrjen e grave. Në rang botëror modelet proporcionale si i yni prodhojnë rreth 5% gra më tepër sesa kemi aktualisht në parlament, dhe në mesataren europiane ne jemi 5% më pak të përfaqësuara në parlament.

(Diskutime pa mikrofon)

5% në mesataren europiane, por duke marrë në konsideratë se janë sisteme mazhoritare një pjesë e konsiderueshme. Ne duhet të krahasohemi me sistemet proporcionale.

Së treti, ne besojmë që rritja e përfaqësimit të grave në politikë, rrit nivelin e demokratizimit të vendit dhe dihet që demokratizimi korelon shumë mirë me uljen e nivelit të korrupsionit shtetëror dhe të kriminalizimit të jetës.

Së katërti, qëllimi i këtyre ndryshimeve nuk është që grave t'ua bëjmë rrugën më të lehtë, por që politikës t'ia bëjmë rrugën më të lehtë. Ne besojmë se gratë kanë shumë çfarë t'i japin politikës në përkushtim dhe në luajalitet.

Pyetja tjetër që, në fakt, ka qenë shumë e debatueshme: Pse na nuk po ia lëmë fatin e përfaqësimit të grave në politikë rrjedhës së lirë të konkurrencës? Përgjigjja është që në

shoqëritë e civilizuara ligjet bëhen që arsyeja ta mund forcën dhe rendi t'ia zërë sa më parë vendin kaosit. Pse me kuotë? Sepse kuota ka funksionuar në Shqipëri që prej 7 vjetësh, ajo ka dhënë rezultat në dy palë zgjedhje dhe ajo tashmë është pranuar si normë.

Së fundi, këto ndryshime janë kontributi i mbështetjes së të gjitha zonjave anëtare të Aleancës së Grave Deputete, që është një trupë ndërpartiake, prandaj është e rëndësishme që ne po kërkojmë mbështetjen e të gjitha forcave politike parlamentare. Këto ndryshime vijnë pas një diskutimi të gjatë me OJF-të e specializuara në çështjen e gruas, me organizmat ndërkombëtarë, OSBE-në, UN Women, kemi pasur edhe diskutime para disa kohësh edhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Ju falënderoj për vëmendjen!

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hafizi!

Fjalën e ka zonja Caka!

Silva Caka – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Hafizi e bëri falënderimin e saj, por falënderimet për koleget tona gra nuk duhet të mbarojnë. Ne të tria duhet t'i falënderojmë shumë koleget tona gra për mbështetjen dhe për prezencën e tyre në çdo iniciativë të Aleancës së Grave Deputete, njëkohësisht falënderime edhe për të gjithë burrat që janë sot prezent.

Fatmir Xhafaj - Po shqyr që e thatë, se është pabarazi kjo.

Silva Caka – Ju falënderojmë shumë mbi të gjitha për pjesëmarrjen dhe për mirëkuptimin.

Në kuadër të relacionit që parashtroi Moza, do të doja edhe unë të shtoja disa objeksione të miat. Projektligji i propozuar vjen si një ekzigjencë e pakundërshtueshme në momentin që po jetojmë sot, pasi aktualisht shoqëria jonë, për shkak edhe të dinamizmit që po përjeton, për shkak të reformave të mëdha dhe të rëndësishme që i kanë dalë para shoqërisë në disa fusha të jetës së saj, po përballlet me realitete të reja sociale, territoriale, ekonomike dhe politike. Ende në ditët e sotme përfaqësimi i ulët i grave në institucionet e zgjedhura është problem, madje në vitet 2008 dhe 2009, ashtu siç e përmendi edhe Moza, u prezantua edhe kuadri ligjor gjinor, me qëllimin e përfaqësimit sa më të lartë të grave në institucione, në politikëbërje dhe në vendimmarrje, konkretisht kuota gjinore e prezantuar në vitin 2008 në Kodin Zgjedhor dhe njëkohësisht ligji “Për barazinë gjinore”, i prezantuar në vitin 2009.

Megjithatë, për shkak të zbatimit të cunguar të këtij kuadri ligjor nga institucionet përgjegjëse, ne sot jemi ende në situatën e një përfaqësimi të kufizuar ose të ulët të grave si në nivelin lokal, ashtu edhe në nivelin e qeverisjes qendrore. Konkretisht, ne kemi tre gra nga 65 kryetare bashkie, madje në vitin 2011 gratë rezervonin vetëm 24,3% të punonjësve civile si drejtuese të larta, dhe 39,2% të punonjësve civile si drejtuese të mesme. Sigurisht, ky raport ka ndryshuar. Paradoksi më i madh, në fakt, vjen për faktin se këto shifra shkojnë në përpjesëtim të zhdrejtë si me raportin gjinor të popullsisë dhe konkretisht 51% e popullsisë janë gra dhe 49% janë burra ashtu edhe me pjesëmarrjen e tyre në votime.

Të dhënat e mbledhura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për herë të parë dhe ndoshta të vetme në vitin 2011, i kërkoj ndjesë zonjës Lefterie, nëse ka një studim dhe unë nuk jam ende në dijeni, tregojnë se gratë edhe vajzat përbënin 50,2% të numrit total të zgjedhësve, pra ishin zgjedhës që e kanë ushtruar efektivisht të drejtën e tyre kushtetuese për të zgjedhur. Gjithashtu, vlen të theksohet se në këto zgjedhje pjesëmarrja ka qenë më e lartë se kurrë nga të gjitha zgjedhjet demokratike që kemi pasur ne, konkretisht 53,47%. Nuk ka ende të dhëna të disponueshme mbi pjesëmarrjen e grave në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013, por besoj, dhe është pak a shumë e konstatuar se nuk ka ndonjë ndryshim të madh në përqindjen e grave, që kanë ushtruar të drejtën e tyre për të votuar.

Gjithsesi, ndryshimet në ligjin “Për barazinë gjinore” për Shqipërinë në vitin 2009 dhe në Kodin Zgjedhor që prej vitit 2008, kanë krijuar sot një terren të favorshëm për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në politikë në rang kombëtar. Konkretisht, në zgjedhjet e përgjithshme të korrikut të vitit 2009, numri i grave anëtare të parlamentit u rrit më shumë se dyfishi, siç e përmendi edhe Moza, nga 7% në 2006-ën në 16,4% në 2009-ën dhe në zgjedhjet e vitit 2013 e deri në ditët e sotme, falë edhe diferencimit të mandatit ekzekutiv nga ai legjislativ ndodhemi në kuotën prej 20,7% të anëtareve gra në parlament.

Në vitin 2013 kemi pasur 6 ministre gra nga 19, ndërkohë që sot janë 7 ministre gra nga 19 që janë gjithsej, dhe njëkohësisht në vitin 2013 kemi pasur 8 zëvendësministre nga 23, pra më shumë se 35%.

Në janar të vitit 2011, në renditjen botërore të *UN Women* Shqipëria u rendit në vendin e 82-të duke u bazuar në përqindjen e grave në parlament me një dhomë ose me dhoma të ulëta, ndërkohë që pati një përmirësim të ndjeshëm në janar të vitit 2014 ku Shqipëria u rendit në vendin e 74 nga 145 shtete të marra në studim.

Në gjykim tim si iniciatore e këtij projektligji, arsyeja më e rëndësishme e hartimit të këtyre ndryshimeve është perceptimi i përfshirjes së grave dhe vajzave në politikë dhe në

vendimmarrje që sa vjen dhe bëhet më pozitive, pra, kemi një qasje gjithnjë e më pozitive kundrejt këtij fenomeni.

Studime të ndryshme të kryera në gjashtë vjetët e fundit konkludojnë se gratë vlerësohen gjithnjë e më shumë për aftësitë dhe kontributin e tyre në fusha të ndryshme sidomos në ato të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, arsimim, politika shëndetësore, çështje sociale etj.

Gratë ndihen të motivuara dhe të bindura se një numër i grave në pozicionet vendimmarrëse do të ofrojnë më shumë zgjidhje për ato dhe për problemet e komunitetit në përgjithësi.

Një raport i *UN Women* dhe *IGA* i vitit 2014 mbi lirinë e votës në Shqipëri ka vlerësuar se kusht i domosdoshëm për rritjen mbështetjes publike për kuotat gjinore është qartësia dhe cilësia e informacionit që i paraqitet publikut mbi qëllimin e kuotave, pra votuesit duhet të informohen mbi kriteret e implementimit të kuotave gjinore të institucioneve ku ato zbatohen, si edhe arsyet pse duhet të zbatohen.

Fushatat sensibilizuese duhet të jenë ato që të informojnë publikun e gjerë, veçanërisht burrat dhe popullsinë në zonat rurale se zbatimi i kuotave gjinore nuk do të thotë se do të zgjidhen gra apo vajza pa kualifikimet e duhura. Në shumicën e rasteve kundërshtimi i kuotave gjinore lidhet pikërisht me këtë frikë se gratë dhe vajzat e zgjedhura përmes kuotave janë të paafta dhe qenia e tyre në pushtet do të krijonte më shumë probleme se sa zgjidhje.

Ky perceptim është totalisht i papranueshëm në kushtet kur në parlamentin e sotëm, me bindje e them, se të gjitha gratë apo vajzat deputete janë aktive dhe produktive jo vetëm në komisionet parlamentare dhe në seanca plenare, por edhe në zonat ku ato janë zgjedhur në kontrast shumë të fortë me disa burra, të cilët vetëm vegjetojnë në parlament, ose më keq akoma janë të përfshirë në afera korruptive dhe kriminale.

Ky studim ka faktuar se 81% e të gjithë të intervistuarve mbështesin më tepër pjesëmarrjen e grave në politikë dhe specifikisht këto statistika vijnë nga 95% e të intervistuarve gra dhe 90% të intervistuarve burra, dhe siç e shohim ka një diferencë prej 5%, por që nuk përbën një diferencë domethënëse, për arsye se do të marrim parasysh edhe faktin se kur burrat janë intervistuar ka pasur nga ata me nivel të ulët arsimimi ose me mentalitet të krijuar nga stereotipe të caktuara gjinore.

Shumica e pjesëmarrësve në studim deklarojnë se do ta mbështesin fuqimisht, dhe këtë e theksoj, përfshirjen e një vajze apo gruaje në politikë ose në vendimmarrje që mund të

jetë e afërmja e tyre, e njohur, mikeshë apo familjare. Ata e perceptojnë këtë rol si mjaft pozitiv dhe e shikojnë si një mundësi për t'u përfaqësuar akoma edhe më mirë.

Në përgjithësi pjesëmarrësit besojnë se duhet të ketë më shumë gra pjesë të politikës dhe institucioneve vendim-marrëse. Ka një tendencë për të menduar se gratë në pushtet janë më të afrueshme sesa burrat për sa i përket komunikimit dhe aftësive të tyre për të trajtuar çështje të caktuara.

Bazuar në përshkallëzimin e nivelit që është përdorur gjatë studimit rezulton se pothuajse 60% e të intervistuarve do ta mbështesnin fuqimisht një grua si kryebashkiake, si presidente, si kryetare të parlamentit apo edhe si kryeministre.

Ka një nivel të ngjashëm mbështetjeje për gratë si anëtare të parlamentit, si ministre apo anëtare të partive politike, ndërkohë është shumë interesant fakti se ka një mbështetje më të ulët për gratë, të cilat mbështesin një kandidat ose që marrin pjesë në protesta politike, pra ky fakt e lidh pazgjidhshmërisht figurën e gruas me protagonizmin dhe jo me prapaskenën.

Aktualisht ne ndodhemi përpara një fakti, atë të reformës territoriale, e cila përveç gjithë eficiencës që sjell në trajtimin e burimeve njerëzore, financiare, apo edhe natyrore do të ketë impaktin e saj pozitiv edhe në çështjet e barazisë gjinore duke krijuar më shumë mundësi për gratë dhe vajzat për t'u përfshinë në qeverisje dhe konkretisht me këto ndryshime ne do të kemi minimumi 12 gra në 61 kandidatë për qeverisjen vendore. Kjo gjithashtu krijon edhe një mundësi shumë të mirë për kandidatet gra, që do të garojnë për këshilltare të qeverisjes vendore.

Një tjetër ndryshim siç e përmendi edhe kolegja që ne kemi propozuar është që edhe KQZ-ja të mos i pranoj listat e kandidateve të partive, të cilat nuk i përmbushin kriteret gjinore të përmendura më përpara, duke e bërë kështu të pamundur garimin e këtyre partive politike në zgjedhje. Kjo pa dyshim, është një masë drastike dhe ekstreme deri diku e konsideruar nga disa kolegë tanët, por sigurisht që do t'i shërbejë qëllimit të zbatimit në mënyrën e duhur të kuotës gjinore bazuar edhe në ligjin "Për barazinë gjinore", madje në pikën 1 të nenit 15 të ligjit 9970, datë 24.07.2008 sanksionon se: "Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur:

a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30% për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;

b) sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kriterëve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe;

c) sigurohet përfshirja mbi 30% e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;

ç) sigurohet përfshirja jo më pak se 30% e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

d) sigurohet përfshirja mbi 30% të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore”.

Këto ishin disa nga objeksionet e mia, për të cilat kam pranuar në mënyrë absolute që të jem edhe pjesë integrale e këtij projektligji të iniciuar nga unë, nga zonja Doda dhe nga zonja Hafizi.

Ju falënderoj edhe një herë dhe shpresoj që ky ligj të votohet ashtu siç është sjellë, pa asnjë lloj ndryshimi.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Me këtë fjalinë e fundit duket si presion mbi komisionin, por do të ishte mirë që mos na dhunoni psikologjikisht.

Silva Caka - Jo, ky nuk është presion!

Fatmir Xhafaj – Po, se nuk të intereson ty! Nga koleget e tjera deputete dëshiron ndonjëra të shprehet?

Po, zonja Shehu!

Mira Shehu - Jemi plotësisht dakord si Aleancë e Grave Deputete me atë që pak a shumë parafolëset folën, që të mbështesim gratë në cilësi, në vlera dhe jo në numra.

Këtë parim duhet ta ketë komisioni, por besoj edhe deputetët meshkuj për faktin se kemi plot gra dhe vajza, të cilat mbartin cilësi të krahasueshme dhe vlera të domosdoshme që të zënë vendet drejtuese në pushtetet vendore, në këshillat bashkiake, në profesionet e ndryshme dhe për të paraqitur me cilësi të lartë një domosdoshmëri në analiza dhe në vendimmarrje apo projektligje, e të tjera me radhë.

Dua të përmend këtu që ne të gjitha së bashku jemi mbledhur dhe kemi paraqitur dhe diskutuar shpeshherë, dhe për të mos thënë që kemi dashur që këtë 40% ta çojmë edhe më sipër, por kemi tentuar ta mbajmë këtu dhe të qëndrojmë në këtë nivel, për arsye që të jetë e padiskutueshme, të vendoset dhe të respektohet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit juve!

Lefterie Luzi - Me qenë se u përmend KQZ-ja dhe unë jam këtu dhe ka lidhje me faktin, me projektligjin.

Fatmir Xhafaj – Jo, një sekondë ju lutem se ky nuk është debat. A keni ndonjë gjë me projektligjin e propozuar me amendamentet?

Lefterie Luzi - Po kam, dhe si fillim do të doja të falënderoja deputetët meshkuj që do të votojnë këtë projektligj, nëse do ta votojnë. Sigurisht që e kemi parë draftin, të cilin e kanë paraqitur zonjat deputete, por mendoj që nga pikëpamja e teknikës legislative ky draft nuk do të sillte rezultatet që propozuesit mendojnë se do të sjellë, për faktin se referuar draftit dhe ndryshimeve që paraqet në kod ky draft ose reflektimeve duhet të bëhen edhe ndryshime të tjera, kështu që unë do të konsideroja që të merrej edhe një herë parasysh. Unë i kam edhe me shkrim të gjitha propozimet e mia në lidhje me draftin si tek i pari, ku konkretisht duhet të hyjmë në kod, gjithashtu, KQZ-ja ka paraqitur edhe rekomandime më përpara, por pikërisht vetëm për *gender*-in.

Ajo çfarë unë do të kërkoja në qoftë se gratë do të ishin dakord për të shtuar edhe një pikë tjetër, e cila është ajo e faktit, që meqenëse ne nuk kemi statistika zyrtare dhe nuk është e mundur që t'i kemi, sepse në kod nuk është parashikuar që në listën e zgjedhësve një nga kolonat të jetë e shkruar edhe *gender*-i, ne u referohemi ashtu sikurse tha edhe deputetja parafolëse vetëm studimeve që bëhen dhe intervistave, dhe do të ishte mirë që...

Fatmir Xhafaj – Dakord! Koalicioni i Vëzhguesve e ka sjellë në zgjedhjet vendore dhe të mos kalojmë në përsëritje.

Lefterie Luzi - Unë nuk e di se çfarë ka sjellë Koalicioni, se unë kam vetëm draftin që ju na e keni dhënë paraprakisht.

Fatmir Xhafaj – Jam shumë dakord me ndërhyrjen tuaj edhe me komentet e bëra. E vlerësoj faktin që ju keni një propozim me shkrim. Të vazhdojë relatori dhe pastaj pyetje nga kolegët.

Armando Subashi – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, unë do të doja ta filloja nga fundi, nga propozimi që kanë sjellë koleget tona dhe në radhë të parë do të doja t'i falënderoja për punën që kanë bërë, për draftin që kanë hartuar, por edhe për prezencën sot këtu në komision.

Sigurisht që është një temë shumë e diskutueshme, shumë e debatueshme sa herë që afrohen zgjedhjet, të paktën gjithë këto vitet e fundit ka qenë një nga gjërat që është diskutuar. Më vjen mirë që zgjedhje pas zgjedhjesh ka ardhur në sensin rritës. Nga pikëpamja teknike unë do të përpiqem të jap mendimin tim, sepse pastaj, gjykoj dhe vlerësoj, që nga

pikëpamja e vendimmarrjes, pa dyshim, që në fund të fundit, ky është një lloj vullneti politik, do të thosha, nga të gjithë ligjvënësit, nga gjithë parlamentit, për të vendosur në raport me propozimet konkrete që kanë ardhur.

Pa dyshim, do të isha dakord që 20% e listës së kandidatëve për kryetar qoftë kur propozohet nga një parti e vetme, qoftë kur propozohet nga koalicione partish t'i përkiste së njëjtës gjini.

Jam dakord me propozimin që vjen në raport me listat shumemërore, por do të doja që ky propozim të kufizohej për zgjedhjet që kemi përpara, për zgjedhjet lokale, dhe këtë rregull nuk mund ta vendosim edhe për zgjedhjet e përgjithshme, të cilat janë pas dy vjetësh të themi. Nuk do të ishte mirë, por as praktike që ne të vendosnim një rregull sot, i cili do të zbatohet pas dy vjetësh, sepse realisht nuk dimë sesi do të zhvillohen ngjarjet dhe i gjithë ky debat që ne po zhvillojmë edhe sot, nuk dimë si do të ecë në raport me këtë. Por, pa dyshim, kur bëhet fjalë për zgjedhjet e përgjithshme sigurisht që gjithmonë ka një debat përpara tyre, i cili fillon që nga sistemi zgjedhor, që zgjidhet dhe që aplikohet deri te modalitetet e tjera. Kështu që të vendosim një rregull sot, i cili i bie që të zbatohet pas 2 vjetësh, besoj se është e tepërt, sepse apriori dhe teorikisht po e them këtë, ne ende sot nuk jemi të sigurt se çfarë sistemi zgjedhor do të kemi pas dy vjetësh. Mund të jetë ky që është, pa pasur asnjë ndryshim, por edhe mund të ndryshojë. Kjo është në vullnetin e forcave politike dhe në vullnetin e parlamentit për të gjykuar mbi këtë bazë. Kështu që le t'ia lëmë kohës së duhur atë që i takon zgjedhjeve të përgjithshme edhe në raport me këtë moment me raportet gjinore. Sot mendoj le të fokusohemi te zgjedhjet lokale dhe ndoshta edhe duke parë ecurinë, edhe duke parë zbatimin konkret të kësaj që ne mund të vendosim për zgjedhjet lokale, për këshillat bashkiakë etj., etj. Kjo pastaj mund të jetë një premisë me argumentet pozitive ose negative, sepse nuk e dimë këtë gjë edhe për zgjedhjet e përgjithshme që mund të jenë pas 2 vjetësh.

Jam pak skeptik dhe realisht jam i dyzuar në dispozitën e fundit dhe sinqerisht nuk jap ndonjë përgjigje nëse mundim të pranojmë këtë ide, që po nuk u zbatua ky rregull, lista të mos pranohet, pra, të mos regjistrohet partia politike. Sigurisht është një lloj sanksioni shumë i ashpër do të thosha. Arsytet mund të jenë të ndryshme, por nuk besoj që moszbatimi i një rregulli që vendosim këtu me 40% të listës dhe një në çdo 3 emra të jetë e së njëjtës gjini edhe mund të mos zbatohet, por mund të jetë për arsye ose për shkaqe objektive diku dhe nuk besoj që do të jetë për shkak të mungesës së vullnetit të partisë përkatëse për ta përmbushur këtë detyrim.

Pyetja që shtrohet është: A ia vlen që për shkaqe objektive, të cilat mund të jenë nga natyrat më të ndryshme, në terren në zona të caktuara etj., etj, ne shkojmë deri në këtë lloj penaliteti sa të penalizojmë partinë iks që të mos marrë pjesë fare në subjektin zgjedhor? Sepse mosregjistrimi i listës do të thotë që subjekti zgjedhor nuk merr pjesë në zgjedhje. Pra, është një masë shumë drastike, do të thosha, dhe duhet ta peshojmë mirë. Mund të gjejmë një formë tjetër për ta shtrënguar akoma edhe më shumë që mund të shikojmë masën e gjobave, që parashikon dispozita përkatëse në kod. Nëse sot është, nuk e di sa është, nuk e mbaj mend, 500 mijë lekë të vjetra, hajde ta shikojmë sa mund ta rrisim. Dhe kjo mund të jetë një lloj, do të thosha, sanksioni që i bën partitë politike të mendohen mirë përpara se të marrin një vendim dhe sigurisht edhe raport me sanksionet financiare që duhet të paguajnë. Kështu që nga kjo pikëpamje mendoj se këto janë gjërat që pa dyshim ne duhet t'i diskutojmë me njëri-tjetrin jo vetëm si komision, por, pa dyshim, edhe më gjerë, sepse e thashë që kjo, në fund të fundit, është një vendimmarrje politike e gjithë kësaj maxhorance dhe besoj se në këtë linjë duhet të ecim kur të kemi parasysh këtë diskutim me të mirat dhe të këqijat e veta.

Për sa i përket draftit tjetër të firmosur nga kolegët tanë deputetë, por që sigurisht ka ardhur këtu mbi bazën e propozimeve që ka hartuar vetë KQZ-ja, u tha që janë propozime thjesht me karakter teknik, janë propozime të domosdoshme. Madje vetë kryetarja e pranoi që pa këto propozime në disa aspekte të rëndësishme puna e KQZ-së është e bllokuar dhe pa dyshim që sa më shpejt të operojmë ne, aq më shpejt do t'i hapim rrugë komisionit që të veprojë.

Ditët ikin shpejt, zgjedhjet po afrohen, kështu që besoj se është shumë i rëndësishëm ky moment. Unë, pa dyshim, do të doja një kohë të mjaftueshme për t'u njohur konkretisht edhe me propozimet e reja që po vijnë sot dhe që janë përgatitur besoj nga KQZ-ja dhe ndoshta për një ose dy ditë duke i diskutuar bashkërisht do të gjejmë mënyrën për t'i integruar në draftin që ka ardhur dhe për të bërë të mundur pastaj miratimin final të tyre për ta përshtatur sa më mirë edhe me hartën e re, edhe me ligjin e ri.

Në raport me draftin që ka ardhur, ligjit i bashkëngjitet një aneks, i cili në një lloj kuptimi përcakton KZAZ-të dhe ku pak a shumë është vendosur që numri i përgjithshëm i tyre të jetë 90. Në fakt po t'i referohemi nenit konkret që është neni 5 i projektit, i cili ndryshon nenin 180 të Kodit, që është shumë specifik si nen, sepse e lidh vetëm me zgjedhjet e vitit 2015. Mirëpo pyetja shtrohet por për zgjedhjet e radhës, për zgjedhjet e tjera? Atëherë do të duhet që sa herë të kemi zgjedhje të merremi pikërisht me këtë nen. Kështu që kjo ndoshta do të donte një përcaktim në mënyrë më të përgjithshme plus që nuk e di nëse sa e

udhës është që përcaktimi i KZAZ-ve të jetë pjesë e ligjit apo mos ndoshta duhet ta shikojmë që ne të përcaktojmë disa kriterë bazë dhe kjo pastaj të jetë një vendimmarrje konkrete e KQZ-së rast pas rasti, dhe mos duhet të ndërhyjmë në ligj sa herë që kemi zgjedhje pikërisht për këtë moment.

Nuk e di, ky është mendimi im. Gjithsesi, pa dyshim vlen ta diskutojmë dhe ta shikojmë edhe në këtë pikëpamje. Pra, unë në parim i mbështes këto. Janë të domosdoshme, sigurisht. Duhet bërë sa më shpejt pa diskutim dhe besoj që një ose dy ditë janë të mjaftueshme që bashkë me KQZ-në me ekspertët bashkë me ekspertët tanë ndoshta edhe me ekspertë të aktorëve dhe faktorëve të tjerë të ulemi këto dy ditë t'i konsultojmë dhe ndoshta të premten apo të hënën kur ta çmoni ju t'i miratojmë nën për nën dhe të jetë gati pastaj për në seancë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Subashi!

Dua të bëj një sqarim. Në momentin që është miratuar kalendari i komisionit ne kemi rënë dakord së bashku me përfaqësuesit e opozitës që të kishim bashkërelatorë, pra, dy relatorë, zotin Subashi dhe zotin Bylykbashi. Për të qenë korrektë edhe me kolegët e opozitës, edhe me kolegët e mi të maxhorancës, por edhe me opinionin publik para pak kohësh zoti Bylykbashi ka qenë bashkëpunues me zotin Subashi për të arritur në një qëndrim të përbashkët.

Më vjen keq që sot opozita nuk është e pranishme dhe që nuk është kontributive në këtë proces kaq të rëndësishëm, që nuk ka të bëjë aq shumë as me maxhorancën, as me opozitën, as me PS-në, as me PD-në, por ka të bëjë me një të drejtë dhe liritë themelore, siç është e drejta e zgjedhjeve. Ka të bëjë me një proces shumë të rëndësishëm, siç është procesi zgjedhor; ka të bëjë me një interes shumë të rëndësishëm të qytetarëve të këtij vendi dhe për fatet e vendit dhe për proceset integruuese të vendit. Do të ishte shumë pozitive që opozita të ishte e pranishme dhe të kontribuonte në këtë proces.

Gjithsesi, emergjenca që ka qenë e njohur prej nesh, është bërë e njohur prej KQZ-së, është bërë e njohur nga shoqëria civile në disa deklaratë publike, që të ecim përpara, sepse nuk mund të ecim, sepse nuk mund të vëmë në diskutim fatin e zgjedhjeve, që janë përtej një partie, apo përtej një interesi të politikës së ditës cilido qoftë ai për më tepër kur është një interes, që ka të bëjë me lojën politike dhe me lojëra politike se sa me qëllimet dhe vlerat e politikës.

Gjithsesi, kjo është një çështje që dua ta mbaj jashtë nga fokusi në të cilin jemi, që është një debat sa ligjor, aq edhe teknik, por isha i detyruar dhe jam i detyruar për transparencë që ta bëjë të qartë këtë fakt.

Shpresoj që duke lënë kohën e nevojshme, edhe të kërkuar, dhe e mirëkuptoj relatorin, jam i bindur që edhe nga ana e tij është mbajtur në konsideratë ky fakt edhe kur kërkohej pak kohë, në mënyrë që t'u japim mundësi edhe kolegëve tanë të opozitës që të njihen me propozimet shtesë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mendon se duhen shtuar krahas këtyre propozimeve, dhe që të kemi mundësi për të pasur një draft kontribut të të gjitha palëve këtu në komision, dhe më pas i votuar konsensualisht edhe në seancë plenare. Por ajo që është shumë e rëndësishme është se procesi zgjedhor prevalon mbi çdo interes tjetër të përditshëm të çdo politike, cilado qoftë ajo. Ne jemi këtu pikërisht për ta shtyrë përpara këtë proces. Mund të vazhdojmë me procedurën normale, me pyetje. Ju lutem, më falni një minutë!

(Mungesë inçizimi).

Zonja Hysi, urdhëroni! Pastaj zonja Caka.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Besoj se ju si kryetar i komisionit nuk jeni të pakënaqur nga puna që kanë bërë gratë në Komisionin e Ligjeve dhe në parlament.

Fatmir Xhafaj - Jo, nuk e thashë atë.

Vasilika Hysi - Dhe besoj se ju kemi mbështetur fort në këtë pjesë.

Fatmir Xhafaj - Po të na mungoni, shqetësohemi.

Vasilika Hysi - Unë kam një pyetje në lidhje me nismën që kanë sjellë gratë e Alencës së Grave Deputete. Dhe unë jam një ndër ato gra që e mbështes fort këtë nismë. Në këtë rast nuk kam konflikt interesi, por kam një pyetje për kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Zonja kryetare, pyetja ime është: bazuar në përvojën tuaj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në sa raste ose në sa lista shumemërore nuk është respektuar detyrimi që përmban neni 67, paragrafi 6, ku thuhet që “të paktën 1 në 3 emrat e parë t'i përkasin të njëjtës gjini”?

Pyetja e dytë ka të bëjë me rastin e zbatimit të nenit 175, i cili bën fjalë për sanksionet që marrin subjektet zgjedhore kur në listat shumemërore ata nuk respektojnë pikërisht këtë kriter, që 1 ndër 3 emrat e parë duhet të jetë e së njëjtës gjini. Sa lista nuk e kanë përmbushur këtë kriter? Dhe nëse është e mundur, a keni bërë ndonjë studim se në cilat

zona zgjedhore është konstatuar ky problem? I bëj këto dy pyetje për të diskutuar më pas, duke rezervuar të drejtën për të bërë diskutim lidhur me propozimin që bëhet në projektligjin e paraqitur nga koleget tona, lidhur me nenet 3 dhe 4 të projektligjit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zonja Hysi!

Zonja Luzi, urdhëroni!

Lefterie Luzi - Faleminderit!

Më vjen keq të them se tri partitë e mëdha nuk kanë respektuar kuotën gjinore, PD-ja, PS-ja dhe LSI-ja. Prapë mendoj, nga pritshmëria juaj, se janë qytetet e mëdha në të cilat këto parti nuk kanë respektuar pikërisht këtë gjë: Tiranë, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë. I thashë shkurt, nëse doni më tepër, mund t'ju them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, prandaj thashë ndryshe nga pritshmëritë në qytetet e mëdha. Dhe dua të them se partitë politike i kanë paguar menjëherë gjrobat, kjo është përtej pyetjes suaj.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Ka pyetje të tjera?

Zonja Caka, urdhëroni!

Silva Caka - Në fakt, unë ndodhem në një konflikt të brendshëm nëse duhet të flas si si iniciatore apo si anëtare e Komisionit të Ligjeve.

Fatmir Xhafaj - Keni pyetje?

Silva Caka - Po, kam një pyetje për relatorin.

Fatmir Xhafaj - Jo, relatorit nuk i bëhet pyetje, gjithsesi, meqenëse është dita e grave, bëje pyetjen.

Silva Caka - Në kuadër të muajit të grave.

Fatmir Xhafaj - Urdhëro, zonja Caka!

Silva Caka - Relatori, meqenëse tha që të parashikojmë disa shkaqe objektive, në mënyrë që të mos i përjashtojmë subjektet zgjedhore nga e drejta e tyre për të kandiduar, ka një ide ndoshta se cilat janë këto shkaqe objektive?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Po, urdhëroni!

Armando Subashi - Jo, nuk thashë që ne të parashikojmë në ligj shkaqe objektive, por thashë që ndoshta zona të caktuara për shkaqe të caktuara, të cilat mund të jenë objektive, dhe unë vetëm këtu e gjej justifikimin, mund të ndodhë që një parti politike, dhe këtu nuk kam parasysh vetëm partitë e mëdha, sepse nëse ne e vendosim këtë ligj, ky i detyron të

gjitha partitë nga fillimi në fund, dhe ndoshta për shkaqe objektive mundet të mos zbatohet ky detyrim. Vlen që ne të shkojmë deri në këtë masë ekstreme sa të mos regjistrojmë fare partinë dhe në një bashki të caktuar kjo parti të mos marrë pjesë në zgjedhje? Kjo është pyetja, sepse gjërat janë parimore dhe ka disa parime shumë të rëndësishme, në fund të fundit, janë parime kushtetuese të cilat duhen vënë në peshore. Kush nga këto duhet të prevalojë? Duhet të prevalojë e drejta e një partie për të marrë pjesë në zgjedhje, apo duhet të prevalojë ky detyrim që ne i vëmë, që po themi se kaq përqind të listës duhet ta keni të së njëjtës gjini dhe po nuk e pate nuk merr pjesë në zgjedhje?

Këto janë disa momente që ne duhet të tregohemi të kujdesshëm, sepse besoj se nuk caktohen me një të rënë të lapsit, prandaj dhe thashë se ndoshta masa mund të duket shumë ekstreme, mund të shikojmë masa të tjera. Vasilika tha se gjoba është 500 mijë lekë të vjetër, mund ta rrisim, s'ka problem, mund ta bëjmë 5 milionë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po ç'lidhje ka me biznesmenët? Lista është e partisë, nuk është e biznesmenit. Lista e këshilltarëve, domethënë 1 bashki ka 41 këshilltarë, po marrim se ka 31 këshilltarë ose 21 këshilltarë, ç'lidhje ka biznesmeni këtu? Në qoftë se një parti mendon se mund të fusë edhe një biznesmen, ai është 1 nga 21 që do të ketë lista dhe nuk është se e pengon ky praninë e grave në listën e këshillit, nuk ka lidhje fare.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Zoti Fino, urdhëroni!

Bashkim Fino - Pyetja e parë që kam për koleget e mia, nuk jam kundër shanseve të barabarta, absolutisht. Dhe e di pse nuk jam kundër? Nuk jam kundër sepse kjo ka të bëjë me faktin që partitë politike duhet të jenë të përgjegjshme dhe partitë politike kanë statusin e tyre. Në statutin e tyre, të paktën partia që unë dhe Vasilika përfaqësojmë, e ka minimalisht 20% në zonat rurale dhe 30% deri në 40% në zonat urbane, që duhet të përzgjidhen gra në zonat drejtuese të partisë socialiste. Ne e kemi vënë në statutin tonë, me siguri edhe partitë e tjera në njëfarë mënyre mund ta kenë kështu. Problemi këtu shtrohet se sa zbatohen këto statute, të cilat as në partitë tona nuk zbatohen, ndërkohë që vjen këtu një propozim dhe kërkohet që të futet në Kod Zgjedhor që ose do të jenë 20% zonja në listën për kryetar bashkie nga 61 kryetar bashkie ose s'ka, thonë këta. Nga ana tjetër, ose të jenë 40% e listës së këshillit të bashkisë prapë zonja, ose duhet të paguajmë gjobë.

E para, ku e kanë gjetur këtë praktikë dhe pse e kanë vënë 20 dhe nuk e kanë vënë 50 me 50, që të jenë të barabarta? Ta kishin vënë 50 me 50 të paktën.

E dyta, pse e diskriminojnë veten kur thonë se duhet të jenë vetëm 40% të grave në listat e këshillave bashkiak?

E treta, çfarë përpjekje bëjnë ato në strukturat e tyre politike, të cilat, më vjen keq ta them, por megjithëse ne e kemi statutin e partisë sonë socialiste, akoma nuk kanë gjetur zbatim, që janë në struktura zgjedhjeje, që duhet të zgjedhim gratë në forume drejtuese në komuna dhe bashki dhe nuk i zgjedhim. Pse nuk e ngrini zërin fort nëpër partitë tuaja kur vjen puna për të zgjedhur dhe për të promovuar shanset e barabarta të grave, që duke i promovuar në parti, absolutisht e kemi më të lehtë për t'i promovuar dhe në zgjedhjet lokale, edhe në zgjedhjet administrative. Prandaj mua më duket një sforcim që bëjnë zonjat deputete që kemi ne këtu në parlament, që e kanë mirëkuptimin tonë dhe që gjejnë artifica duke vënë përqindje 20% dhe 40%, duke diskriminuar në njëfarë mënyre shanset e barabarta. Pyetja që kam është pikërisht kjo gjë: a e zgjidh kjo gjithë këtë situatë? Kjo, për mendimin tim, nuk e zgjidh për sa kohë nuk janë të liberalizuara dhe të ndërgjegjësuara partitë politike për ta zgjidhur në statutat e tyre që e kanë atje në funksion të partisë së tyre dhe, po e patën ato, një nga partitë më liberale është Partia Socialiste, që e ka vënë dhe e ka në qendër të vëmendjes një gjë të tillë dhe prapë ka të meta, që duhet të rregullohen më shumë, atëherë nuk mund ta zgjidhim në rrugë artificiale, me forcë duke e vënë në Kodin Zgjedhor.

Prandaj them se edhe kjo e vënë kështu, nuk më duket shumë e përshtatshme se mund ta vëmë, mund të ngremë dorën, mund ta miratojmë dhe partitë politike të thonë: “Jo, nuk gjetëm dot një kandidaturë të përshtatshme në një bashki...” dhe të mos harrojmë se kemi bërë një reformë territoriale të rëndësishme. Që tani kemi vetëm 61 bashki, hiq ato tre bashkitë e vogla, dy të minoritetit dhe një Pustecin, kemi 58 bashki të mëdha me një sipërfaqe të madhe. Nuk po them se nuk mund të gjejmë, por sipërfaqja dhe e gjithë struktura e një bashkie kaq të madhe... mundet Partia Demokratike të thotë: unë nuk gjej dot dhe do të gjej Bashkimin, po marr emrin tim për të mos u keqkuptuar me ju zonjat, në filan bashki për ta kandiduar. E çfarë? Tani, meqenëse ne duhet ta vëmë në ligj, duhet të gjejmë se s'bën një femër që të detyrohem të humbasim një bashki? Kështu do të mendonte partia ime, kështu do të mendojë partia tjetër e kështu me radhë. Prandaj duhet të jemi pak fleksibël.

Cili është propozimi im, zoti kryetar? Propozimi im është që partitë politike duhet të respektojnë shanset e barabarta dhe të kenë mundësinë, ta vëmë te ky nen, për të propozuar shanset e barabarta, pra edhe gratë në drejtim të bashkive.

Fatmir Xhafaj – Pyetjen të lutem!

Bashkim Fino – Më falni, e kam edhe pyetje, edhe diskutim që të më kthejnë përgjigje ato, të më kthejnë përgjigje edhe për diskutimin që bënë.

Më falni, se erdha pak me vonesë, se isha në një takim më pak të rëndësishëm nga ky!

Po vumë ne tani përqindje, më duket sikur e kornizojmë, ashtu siç mund të jem dakord se në këshillat bashkiakë absolutisht mund të lëmë një lloj përqindjeje se është më se e pranueshme që vërtet duhet të ketë një përqindje të caktuar, por të mos harrojmë se sapo të kemi të bëjmë me një reformë territoriale, dhe është një reformë shumë e fortë, të cilën do ta provojmë në territor edhe në këto zgjedhje që do të vijmë, por edhe në drejtimin e tyre, pa dashur të fyej askënd, përkundrazi, jam në mbështetje të tyre. Prandaj e bëra pyetje-sugjerim, zoti kryetar, për të marrë përgjigje dhe për ta rregulluar nenin 1 apo nenin 67/6 që kanë sjellë zonjat propozuese këtu.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Përqendrohemi te pyetja.

Fjala për ju, zonja Hafizi, për një reagim tuajin.

Mimoza Hafizi – Për t’iu përgjigjur zotit Fino, meqenëse ai bëri pyetjet e fundit, ne nuk i kemi diskriminuar gratë me këtë ligj, sepse në ligj nuk shkruhet që minimalisht 20% të jenë gra, por 20% t’i përkasin secilës gjini. Kështu që gratë me këtë ligj mund të shkojnë edhe në 80%, por jo mbi 80%.

Pse vumë 20% dhe...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Mimoza Hafizi – Po shpjegoj të vërtetën!

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Së dyti, pse nuk thamë 50%? Unë e justifikova në argumentin që dhashë në fillim. Ne aktualisht jemi 1% dhe, të kalojmë nga 1% deri te... Në fakt, kemi kolegë këtu që kanë thënë edhe 30%, por na u duk një hap shumë i madh dhe thamë të fillojmë gradualisht me hapa më të vegjël. Pra, 20%-shi na u duk një shifër e arsyeshme, gjithsesi kjo është e debatueshme dhe jo ndonjë shifër e rënë nga qielli.

Po i marr të gjitha përgjigjet me radhë.

Së treti, për objeksionet e zotit Subashi.

Në lidhje me propozimin e tij që të ndahen çështjet e zgjedhjeve të ardhshme vendore me zgjedhjet e ardhshme parlamentare, unë po jap dy argumente që shkojnë kundër mendimeve të zotit Subashi.

E para, në ligjin aktual, në Kodin Zgjedhor është i njëjti nen që rregullon edhe listat shumëmemërore të parlamentit, edhe listat shumëmemërore të këshillave bashkiakë. Ka një arsye, sepse në fakt është e njëjta frymë, e njëjta ide. Domethënë, pjesëmarrje gjinore në qeverisjen vendore ose në qeverisjen qendrore, pra e njëjta ide i mbështet të dyja. Kështu që unë them të mos i ndajmë, sepse, po i ndamë, me siguri do të krijojmë shumë probleme edhe teknike dhe nuk ka kuptim që të njëjtin argument ta ndajmë në dy copa. Në qoftë se është fjala që ne mund të reflektojmë më shumë për zgjedhjet e ardhshme parlamentare se ka kohë, le të bëjmë një herë këto ndryshime dhe pastaj ta shohim pas dy vjetësh prapë. Në qoftë se është fjala që do të ndërhyjmë se do të ndërhyjmë, të ndërhyjmë mbi bazën e asaj eksperience që është krijuar në zgjedhjet lokale.

Për sa i përket nenit të gjobës, ne jemi absolutisht kundër, sepse gjoba nuk ka funksionuar, është një eksperiencë e dështuar, ndaj pse ne duhet t'i mbetemi një eksperiencë të dështuar? Ndërkohë, të fusim një eksperiencë të re, e cila, për mendimin tonë, nuk prek asnjë të drejtë të njeriut, sepse besoj se nuk është vetëm kushti gjinor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund ta thotë më mirë për të refuzuar listat e partive ose është edhe pastërtia e figurës së kandidatëve për deputet. Atëherë, edhe kjo do të ishte thyerje e së drejtës kushtetuese të kandidimit? Ne vendosim disa kritere që një parti ose koalicion e shohim se e ka totalisht të mundur t'i plotësojë, sepse shpërndarja e grave në të gjithë Shqipërinë është e barabartë, 50% ka gjithkund gra. Partitë le të përpiqen që t'i gjejnë gratë dhe t'i kandidojnë.

Unë jam shumë dakord me zotin Fino që thotë: “Ne duhet të luftojmë brenda partive”. Nuk është momenti këtu për të diskutuar. Ne kemi bërë një përpjekje shumë të madhe edhe për kualifikimin politik të grave brenda partive tona, por ka dy rrugë: rruga e gjatë që kalon përmes partisë dhe rruga e shkurtër që kalon përmes Kodit. Ne le t'i eksplorojmë të dyja rrugët.

Rruga e shkurtër, unë e thashë që në argumentin tim, është e arsyeshme që civilizimet e përdorin që arsyeja të mundë forcën.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në fakt, që të jem i sinqertë, ky është një ligj për kryetarët e partive, që ta kuptoni, se ata firmosin në fund fare, nuk është për partitë me sistemin që kemi sot. Kështu që ky është penalizues për ata. Ata duhet ta kuptojnë. Unë e vlerësoj thirrjen që bëni ju, por e bëni për një rreth të kufizuar. Ka pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po nuk ke pyetje, jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Fjalën e ka zoti Majko, pastaj zonja Hysi dhe zonja Caka, zonjat Hafizi dhe Luzi mund të bëjnë komente nëse kanë gjë. Kolegët të shtrojnë çështje që kanë nevojë për reagim për propozimet respektive që kanë bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fillojmë se është me procedurë.

Pandeli Majko – Unë mendoj se propozimi që kemi sot në tavolinë është diskutuar mjaft dhe ai duhet të mirëkuptohet në disa drejtime, përveçse duhet të shikohet si një reformë e caktuar legislative për Kodin Zgjedhor.

Mendoj se të gjitha koleget e respektuara, që kanë sjellë propozimin, janë përpjekur të sjellin një moment evolutiv për sa i përket përfaqësimit të grave jo vetëm politik, por edhe në institucionet e tjera (kam parasysh njësitë e pushtetit vendor), duke pasur parasysh edhe traditën shumë maskiliste që ka ekzistuar në Shqipëri. Këtë duhet ta themi kështu siç është, madje me humor unë di se ka pasur dikur edhe rrethe ku kryetarja e gruas ishte burrë, se nuk gjenin dot një grua.

Mendoj se ne duhet t'i përgjigjemi kësaj situatë që ekziston aktualisht në Shqipëri dhe që është një revolucion, nëse mund ta quajmë kështu, i fshehur, jo shumë publik, por që bazuar mbi eksperiencat e gjithsecilit është mëse i dukshëm. Kështu që unë do të mendoja që edhe propozueset janë ndodhur përballë limitimit të një presioni që vjen nga tradita. Ku e kam fjalën? Përsëri për trupat përfaqësuese, po flas për trupat proporcionale, e kanë sjellë përfaqësimin e grave në nivelin 40%.

Tani, të nderuara kolege, shumë shpejt këtu bëme edhe një diskutim të vogël edhe me koleget e tjera juriste, neni 18 i Kushtetutës shprehet qartë: “Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe gjinore.”

Nëse do të isha në vendin tuaj dhe sot do të kisha kundërshtimin e kolegëve tuaj, me këtë nen do të shkoja edhe në Gjykatën Kushtetuese për ta kërkuar të drejtën tuaj legjitime edhe në një mënyrë tjetër, por dëshiroj të them se në kushtet kur edhe politika, pra partitë kryesore janë shprehur që në këto zgjedhje përfaqësimi i grave do të jetë në nivelin 50% me 50%, pra të gjitha partitë kryesore, unë mendoj që kjo të paktën duhet të shprehet edhe në propozimet që keni bërë. Pra, barazia nuk duhet të jetë e shfaqur me përfaqësim diskriminimi pozitiv, por barazia ka parametra matematikë. Parametri matematik është 50 me 50. Kështu

që unë do t'i bashkohesha çdo lloj zëri apo çdo lloj vote që do të respektonte nenin 18 të Kushtetutës që në përfaqësitë proporcionale të kishim përfaqësim të barabartë të burrave dhe të grave. Kjo është edhe në frymën e Kushtetutës, ashtu siç e kuptoj unë.

Në fund edhe politika është matematikë. Ne do të diskutojmë votën e 84-të, në qoftë se do të diskutojmë miratimin e këtij projektligji. Ç'rëndësi ka nëse do të jetë burrë apo grua? Në këtë këndvështrim, mendoj se propozimi juaj ka ardhur në momentin e duhur. Mund ta diskutojmë këtë nëse do ta hapim precedentin për të dyja rastet, për zgjedhjet lokale dhe pastaj do të presim zgjedhjet e përgjithshme, duke pasur parasysh se ka një diskutim deri edhe për ndryshimin e Kushtetutës, por që është gjithmonë probabilitet.

Këtë do ta lë në gjykimin tuaj. Nuk mund të flas në emër të propozuesve, por ajo që dua të insistoje është: në trupat proporcionale numri i përfaqësuesve të jetë i barabartë për të dyja gjinitë. Të hidhen përpjetë ku të duan: jo kemi, jo s'kemi. Kanë. Të gjithë kanë gra në shtëpi, që u rrisin fëmijët dhe u gatujnë.

Në këtë pikëpamje, bazuar edhe në eksperiencën time (nuk kam lëvizur në një apo në dy rrethe, por e kam marrë shtëpinë nga Veriu në Jug) dhe i përkas të dyja lloj kulturave, sepse vetë jam nga Jugu dhe gruan e kam nga Veriu, nga kjo pikëpamje mendoj, se 40-ta (diskriminimi pozitiv), duhet të shkojë në barazim 50-50%.

Sa i përket konceptit të përfaqësimit me protagonizëm në zonat maxhoritare, kjo është në diskrecionin e një diskutimi të brendshëm dhe psikologjik, sepse një diskutim është një lloj terapie në shoqëri, që është e mësuar, por bën sikur është e pamësuar. Më mirë ta them unë këtë, sesa të thuhet në korridor, pas mbledhjes. Në këtë këndvështrim, sipas mendimit tim, unë do të isha për diskriminim pozitiv me 30% dhe jo 20%, sa është.

Edhe një herë dëshiroj të shpreh përkrahjen time për ...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po më ngacmojnë tani kolegët dhe po më thonë të jetë me 2 standarde. Mos më detyroni, se e bëra propozimin 50-50%. Jam dakord, edhe për Tiranën.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Moza dhe Vasilika e dinë shumë mirë, se unë kam folur me to para mbledhjes, por dëshiroj të them, se është propozim në kohën e duhur dhe të gjithë ne, kolegët burra, pavarësisht se bëjmë shaka dhe ngacmohemi, e përkrahim këtë projektligj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Thuaj që po bëjmë shaka, se vetëm me gratë nuk bëjmë dot shaka, se mbetemi pa drekë sot.

Po bëjmë një ndërhyrje: një përfaqësuese nga Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë dhe një përfaqësuese nga CRCA-ja, që është një përfaqësuese e organizatave të Shoqërisë Civile në fushën e të drejtave të grave.

Zonja Meta, drejtore Ekzekutive e Shoqatës për Kulturë Demokratike, pjesë e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë dhe zonja Edlira Çepani, e Rrjetit të Grave “Barazi në vendimmarrje”, përfaqësuese e CRCA-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ju lutem, a ka mundësi të fillojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Blerina Metaj – Përshëndetje!

Në emër të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, gjejmë rastin t’ju falënderojmë për mundësinë që na dhatë, për të qenë pjesë e këtij diskutimi në komision dhe për të deklaruar në lidhje me mendimet dhe sugjerimet që Koalicioni ka sjellë në vijimësi, me raportimet dhe deklaratat e herëpashershme, duke deklaruar për procesin në vijimësi. Ne kemi bërë disa rekomandime konkrete drejtuar të gjithë anëtarëve të komisionit, kryetarit të Kuvendit, grupeve parlamentare për dijeni Kryeministrit të Shqipërisë, kryetarit të Partisë Demokratike, kryetarit të PBDNJ-së dhe disa aktorëve të tjerë potencialë, të cilët kanë interes për ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Drejtimi ndaj të gjithë aktorëve potencialë është një merak dhe një shqetësim që e ka Koalicioni, me idenë që këto reforma të rëndësishme, të cilat janë prurje të reja për të ndihmuar procesin dhe garën elektorale në Shqipëri, duhet të kenë unanimitetin dhe gjithëpërfshirjen e të gjithë aktorëve politikë, që të mos jetë një krahë marrje e maxhorancës aktuale, vetëm nga një krah, por duhen gjetur të gjitha mekanizmat meqë trendi i këtyre reformave të rëndësishme në Shqipëri, ashtu siç janë reforma elektorale dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor, duhet patjetër të kenë një reformë gjithëpërfshirëse, me të gjithë aktorët politikë në tavolinë.

Pavarësisht se zoti Xhafaj e shpjegoi arsyen se përse nuk është prezente opozita në Komisionin e Ligjeve, ne insistojmë si koalicion, të merret edhe mendimi i tyre politik për këtë reformë elektorale.

Kemi qenë shumë seriozë dhe shumë të drejtpërdrejtë në rekomandimet që janë iniciuar nga deputetët përkatës. Ndërkohë, kemi qenë të drejtpërdrejtë, edhe në takimin që kemi bërë dje, me Kryetarin e Kuvendit dhe falënderojmë komisionin që reagoi nga apeli që bëri Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, në lidhje me përshpejtimin e kësaj procedure, për t’i shërbyer asaj që të gjithë presin dhe ajo që është më e rëndësishme, jo vetëm politikanët, por

qytetarët, votuesit shqiptarë presin të orientohen drejt, se si do të jetë mënyra e tyre e votimit dhe cilët do të jenë ata që do t'i përfaqësojnë në garën e radhës.

Lidhur me ftesën e bërë për 2 projektligjet koalicioni shpreh sugjerimet e tij, si më poshtë. Meqë koha është e kufizuar, do të mundohem të jem shumë koncize.

E kemi të shkruar çdo gjë dhe do t'jua lëmë.

Fatmir Xhafaj – Nëse e keni të shkruar, mendoj se mund të na e lini. Kohën për të folur e keni 5 minuta.

Blerina Metaj - Në rregull.

Lidhur me projektligjin e parë, lidhur me ndryshimin e Kodit Zgjedhor dhe me deputetët që e kanë iniciuar (zoti Klosi, Manja, Muçmataj dhe zoti Vasili), Koalicioni ka renditur në mënyrë të detajuar, shqetësimin për ngritjen e komisioneve zonale të administrimit zgjedhor, i cili është një ngërç aktual, është një gjendje alarmante, ku KQZ-ja nuk mund të punojë, pa u ngritur më parë komisionet zonale. Parashikohet ndarja e territorit në këto komisione. Projektligji nuk parashikon ndryshimin kriterit ligjor të parashikuar në nenet përkatëse, që i keni të referuara në vazhdimësi.

Në draftin e propozuar është me interes që ky numër i lartë zgjedhësish në këto ZAZ dhe pamundësia e shtimit të numrit të vendeve respektive të numërimit të votave, do të bëjnë, që në këto ZAZ procesi i numërimit të zgjatet më shumë se në ZAZ-të e tjera, duke krijuar premisa për tension artificial të situatës, pasi rezultati final i zgjedhjeve në ato bashki, do të varet nga rezultati i shpallur nga KZAZ-ja. Në këtë pikë, Koalicioni sugjeron zbatimin e kriterit ligjor për numrin e përafërt, rillogaritje ose shtim të numrit të ZAZ-ve.

Në lidhje me projektligjin e iniciuar nga disa deputete femra dhe neve na vjen shumë mirë që është marrë një iniciativë e tillë, Koalicioni ka mbështetur në vazhdimësi dhe me forcë rritjen e përfaqësimit të grave dhe zbatimin e ligjit mbi kuotat gjinore të parashikuara në ligj.

Duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të ligjit, kushtet konkrete të zbatimit të tij, nivelit të brendshëm të përfaqësimit në të gjitha partitë politike, krijimin e kushteve plotësisht të mundshme për t'u arritur nga të gjitha subjektet elektorale, që do të garojnë në zgjedhjet vendore dhe mbi të gjitha, sfidën e vendit për zbatimin tërësor të ligjit, Koalicioni sugjeron: vendosjen e kuotës 30% për këshillat bashkiakë, zbatimin e kriterit 1 në 3 në të gjithë listën e paraqitur, vendosjen e kriterit 30% të listës fituese për gjininë më pak të përfaqësuar, zbatimin e procedurës së zëvendësimit, në rast të dorëheqjes së një këshilltari nga gjinia më pak e përfaqësuar, përcaktimin e qartë në ligj të refuzimit të listës prej

KZAZ-ve apo KQZ-së, në rast të mospërbushjes së kriterit 30%. Për këtë është i nevojshëm rishikimi i nenit 67.

Plotësimi i listës së zgjedhësve vjen për herë të parë në rekomandimet që Koalicioni apo aktorët e Shoqërisë Civile e rendisin në mënyrën sesi duhet të përfshihet në ndryshimin e Kodit Zgjedhor, ku janë nënshkruesit, votuesit të ketë edhe një kolonë për shënimin e gjinisë së votuesit.

Po ashtu, ndryshimet duhen bërë të mbajtura në procesverbalet përmbyllëse të qendrës së votimit, ku duhet të shtohet e dhëna sa votues femra dhe sa meshkuj kanë marrë pjesë në votim.

Besoj se do të rishikohet me kujdes, sepse është një statistikë që do t'u hyjë në punë partive politike në politikat vendimmarrëse apo zhvilluese për të inkurajuar pjesëmarrjen e grave dhe për të parë realisht, sa pjesë të gjinisë votojnë dhe marrin pjesë realisht në procesin zgjedhor në Shqipëri. Për këtë është e nevojshme prekja e neneve 49, 105 dhe 113.

Përpos propozimeve lidhur me dy projektligjet e mësipërme, Koalicioni i Vëzhguesve sjell në vëmendjen tuaj edhe dy çështje të tjera, që vijnë si pasojë e adresimeve, pas miratimit të ligjit të ri për administratën territoriale, reformën administrativo-territoriale dhe në funksion të rritjes së transparencës dhe informimit të publikut, lidhur me zgjedhjet e organeve qeverisëse në njësitë e reja.

Njëkohësisht, lidhur edhe me sqarimin e dispozitave, lidhur edhe me kandidatët e pavarur, konkretisht koalicioni sugjeron që listat e këshilltarëve të bashkisë, të paraqitura nga partitë politike brenda KZAZ-ve dhe KQZ-së të bëhen publike për qytetarët sipas formave të parashikuara në kodin zgjedhor për kandidatët për deputetë, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së.

Për këtë është i nevojshëm amendimi dhe plotësimi i nenit 73 të Kodit Zgjedhor. Koalicioni vlerëson si të domosdoshëm plotësimin e kuadrit ligjor lidhur me kandidimin e kandidatëve të mbështetur nga zgjedhësit. Lidhur me këtë, në Kodin Zgjedhor, për këta kandidatë nuk parashikohet nivel tavan i mbledhjes së nënshkrimeve, po t'i referohemi nenit 70, paragrafit 3.

Njëkohësisht është e paqartë në situatën e re të krijuar se si do të interpretohet e do të zbatohet neni 70, pika 4, lidhur me përfaqësuesit aktualë të organeve të njëjësive të qeverisjes vendore, nëse ata do të duan të kandidojnë si kandidatë të pavarur. Për këtë është i nevojshëm ndryshimi i nenit 70 dhe konkretisht i pikës 3 dhe 4.

Këto janë disa nga rekomandimet me të cilat koalicioni u është përgjigjur të dy projektligjeve që janë vënë në shqyrtim për t'u ndryshuar dhe janë ofruar nga iniciativat e katër deputetëve respektivë. Mendojmë se do të jemi kontribuues në atë çka ne mendojmë, që procesi duhet të jetë shumë transparent dhe Kodi Zgjedhor të marrë ndryshimet e miratuara sa më shpejt që të jetë e mundur të të zgjidhet ngërçi e t'u lihet kohë institucioneve përkatëse që merren me menaxhimin dhe miradministrimin e zgjedhjeve në Shqipëri.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe interesin!

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Faleminderit për çfarë parashtruat!

Duhet t'ju bëj me dije dy gjëra, që t'i saktësoj. Kjo mbledhje komisioni ka qenë në kalendar. Është mbartur herë pas here për shkak të mungesës së opozitës. Me thënë të drejtën, po na dhanë ata ndonjë këshillë për ndonjë mekanizëm, se si ta zgjidhim, ne do t'u ishim shumë mirënjohës. Ndonjë mekanizëm nuk dimë deri tashti. Po na ndihmuat ju, do ta mbajmë shënim e do të jemi të vëmendshëm.

Sa u përket propozimeve konkrete, do t'ju lutesha që t'i dorëzoni me shkrim, në mënyrë që t'u jepni mundësi edhe relatorit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe këshilltarëve tanë, që të punojnë mbi dispozitat, nenet përkatëse, për t'i reflektuar për aq sa është e mundur. Edhe një herë e bëj të qartë: ne nuk do të tejkalojmë jashtë nevojave që kemi për normalitetin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e pritshme vendore. Nuk e kemi këtë tagër dhe nuk e marrim përsipër të tejkalojmë përtej kësaj domosdoshmërie. Çdo propozim tjetër që nuk shkon me këtë linjë, nuk do të diskutohet fare nga ky komision, por do diskutuar kur të jetë një moment i përshtatshëm, ashtu siç thatë edhe ju, që të jenë të gjitha palët të përfshira aktivisht në këtë. Do të respektojmë edhe këtë kërkesë të arsyeshme.

Po, zonja Çepani, në emër të CRCA-së, apo jo? Janë katër organizata që përfshihen këtu, në mos gaboj, të cilat jeni emëruar ju që t'i përfaqësoni.

Edlira Çepani – Zoti kryetar i komisionit!

Shumë faleminderit për këtë mundësi, për të thënë edhe ne fjalën tonë si përfaqësues jo vetëm të katër koalicioneve në lidhje me gratë në vendimmarrje, që janë: “Koalicioni i grave dhe i të rinjve në politikë”, “Rrjeti i grave barazi në vendimmarrje”, “Rrjeti për fuqizimin e gruas në Shqipëri” dhe “Rrjeti i grave për demokracinë në Shqipëri”, të cilat në fakt përfaqësojnë më shumë se 100 organizata, të cilat ndodhen në të gjithë Shqipërinë e që unë kam nderin t'i përfaqësoj ato këtu sot, me propozimet e tyre përkatëse.

Faleminderit zotërinjve deputetë për këtë seancë e për të gjitha komentet dhe sugjerimet e tyre! Për ne është shumë pozitive që dëgjojmë debatin tuaj, që dëgjojmë

sugjerimet dhe mendimet tuaja, dhe ju falënderojmë për gjithë pozitivitetin me të cilin është trajtuar kjo çështje, që në fakt nuk është një çështje e të drejtave të grave, por është një çështje e të drejtave të njeriut dhe e përmirësimit të komunitetit dhe të Shqipërisë në përgjithësi.

Më lejoni edhe një herë të falënderoj “Aleancën e grave deputete”, të cilat kanë bërë një propozim shumë të mirë për këtë komision dhe për ndryshimet në Kodin Zgjedhor, të cilat në fakt janë një shembull i jashtëzakonshëm se si mund të funksionojë një organizëm parlamentar ndërpartiak. Ky është një hap përpara, një shembull i jashtëzakonshëm që japin gratë, se sa mirë mund të funksionojnë kur vjen puna për të bashkëpunuar për të drejtat dhe për të mirën e Shqipërisë, të gjitha grave dhe komunitetit në përgjithësi.

Më lejoni të falënderoj, gjithashtu, edhe kryetarët e partive, e dy partive më të mëdha, të cilët ishin të parët që dolën me propozimin, sidomos për zgjedhjet vendore 2015, që listat shumëemërore të kishin një përfaqësim prej 50% të grave e të burrave, ashtu siç ishte edhe ideja e zotit Majko, të cilin e falënderoj. Një propozim avangardë, do të thosha. që ne e përgëzojmë si shoqëri civile dhe shpresojmë që ky propozim, pse jo, të reflektohet edhe në ligj, edhe lista, jo vetëm për zgjedhjet vendore 2015, por edhe për zgjedhjet qendrore, e dhe për zgjedhjet vendore në vijimësi.

Falënderoj edhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se në fakt është hera e parë që një institucion i tillë merret me të drejtën dhe me pjesën e kuotës gjinore, gjithashtu, edhe organizmat ndërkombëtare.

Ne i kemi parashtruar me shkrim kërkesat tona, përpara se të paraqiteshin në këtë komision. Megjithatë, unë po përmend disa nga më kryesoret. Kërkesat tona kryesore janë që për zgjedhjet në Kuvend, në çdo zonë zgjedhore, të paktën 40% e listës shumëemërore, si për zgjedhjet qendrore ashtu edhe për zgjedhjet vendore, pra 40% e kësaj liste t’i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar, pra secilës gjini.

Gjithashtu, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të paktën 40% e listës shumëemërore për këshillat vendorë dhe për kryetarë të njësisë së qeverisjes vendore, duhet t’i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron kandidatët dhe vendet sipas kuotës gjinore.

Ashtu siç tha edhe zoti Fino, është shumë e rëndësishme që kjo punë të bëhet paralelisht edhe me punën brenda partive, për të angazhuar s amë shumë gra dhe vajza edhe në zonat rurale, por kjo nuk do të thotë që një reformë të presë tjetrën; duhet të ecin në mënyrë paralele, dhe e vetmja pjesë me të cilën unë nuk jam dakord, është që nuk ka gra dhe

vajza; Shqipëria ka gra dhe vajza të jashtëzakonshme. E në fakt, në pjesën e arsimit është shumë më lart përqindja e vajzave dhe grave të arsimuara. Vetëm me pas kur duan të hyjnë në politikë nuk konsiderohen si kandidatura të mjaftueshme. Kështu që, puna paralele është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe ne e mbështesim në çdo strukturë, si në strukturat partiake, në parlament, si dhe në vendimarrjen lokale.

Një propozim tjetër që ne kemi, është që të vendoset si detyrim ligjor ndaj çdo partie politike që merr pjesë në zgjedhje, që të paktën një në tre në listat shumëemërore, në çdo listë elektorale, edhe për deputetë, edhe për anëtarët e këshillave bashkiakë, se është bërë reforma.

Në rastin e nenit të sanksioneve, ne sugjerojmë, ashtu si aleanca e zonjave deputete, që KQZ-ja të refuzojë listat shumëemërore dhe ato të kandidatëve për zgjedhjet në Kuvend për çdo zonë zgjedhore të subjektit zgjedhor që nuk ka zbatuar detyrimet e nenit 67.

Për mendimin tonë ky nuk është një sanksion që i përjashton partitë nga mundësia e tyre për të garuar në zgjedhje. Është thjesht një sanksion që e kthen listën mbrapsht, për t'u përmirësuar dhe për të zbatuar ligjin.

Ne nuk besojmë se vendosja e një vlere monetare mund të jetë serioze për një nen kaq serioz dhe për një përfaqësim kaq serioz, sa ç'është edhe parlamenti, e dhe përfaqësimi në nivel lokal të një shoqërie, e cila në fakt është 50% me 50% e përfaqësuar në gjini. Duke qenë se politika duhet të jetë një institucion përfaqësues, atëherë përfaqësimin në institucionet vendimarrëse duhet ta kemi ashtu siç e kemi në popullatë. Pikërisht për këtë sanksionin për zbatimin e kuotës gjinore, siç e quajmë ne, i këtij neni kaq të rëndësishëm sa ç'është neni 67, duhet të jetë një sanksion i fortë, për të garantuar zbatimin e ligjit, gjë që nuk bien ndesh as me Kushtetutën e as me mundësinë e partive për të garuar në zgjedhje, sepse është thjesht një mundësi për të përmirësuar listën, për të zbatuar ligjin e për ta ridorëzuar atë në mënyrën e duhur.

Unë ju falënderoj dhe jam e hapur për çdo pyetje që mund të keni.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Besoj se jemi të qartë me prezantimet e dy organizatave. Që të jem i sigurtë, po të më pyesnit mua, po të isha në vendin tuaj, do të kisha sjellë burra që ta mbrojnë këtë çështje nga organizatat tuaja.

(Diskutime pa mikrofon)

Edlira Çepani – Nga 100 organizata që ne përfaqësojmë, patjetër që ka edhe pjesëmarrje burrash. Edhe në popullatë, nga të gjitha sondazhet që ne kemi kryer, burrat dhe djemtë janë gati për të votuar vajza dhe gra edhe për zgjedhjet vendore.

Fatmir Xhafaj – Në Shqipëri e në Ballkan është kollaj kur bën sondazh për të tjerët, po kur e bën për veten është mirë. Se i pashë këto organizatat tuaja...

(Diskutim pa mikrofon)

Më fal, më fal, s'ka gjë. I pashë këto dhe përveç Premtos këtu, s'më figuronte asnjë në burg. Por, meqenëse është i vetmi dhe është i diskriminuar brenda të gjitha këtyre organizatave, unë do t'i jap fjalën.

Po, zoti Gogo.

Premto Gogo – Faleminderit, zoti kryetar!

Atëherë, desha thjesht të theksoja diçka lidhur me vërejtjen që bëri pak më parë zoti Fino, në lidhje me çështjet që me të drejtë ai shtroi, nëse a e zgjidh problemin vendosja e një kuote, kur realisht ne kemi partitë që nuk e respektojnë kuotën në përfaqësimin e brendshëm. Ndërkohë ne kemi një kuadër ligjor, kemi një strategji të barazisë gjinore, që po na shkon në shifrën prej 30%. Koalicioni, në gjithë veprimtarinë e vet, e sheh si sfidë, sikundër edhe e prezantoi kolegja ime pak më parë zbatimin e ligjit. Ne jemi të mendimit që më mirë të vendoset një kuotë, e cila të zbatohet, sesa një kuotë që ta bëjë të pazbatueshëm ligjin. Ne mund ta parashikojmë edhe 50%, por do të ndodhemi para faktit të kryer, do të mbetemi pa parti, që do të marrin pjesë në garën elektorale, atëherë do ta pranojmë moszbatimin e ligjit. Nga kjo pikëpamje më mirë të vendosim një kriter të qëndrueshëm që është 30%, i cili është në funksion të kuadrit ligjor dhe nga ana tjetër justifikon pjesën e refuzimit të listës apo të mospranimin të subjektit elektorale si pjesëmarrës në zgjedhje, sepse indirekt detyrohet partia të respektojë këtë kuotë edhe brenda përfaqësimit në strukturat e brendshme. Flas për këshillat vendorë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

E mbylлим këtu seancën dëgjimore me organizatat dhe shoqërinë civile.

Fjalën e kanë kolegët deputetë për diskutime.

Faleminderit zonja Genta Meta, zonja Çepani, zoti Gogo.

Po, të dëshironi, mund të ndiqni seancën.

Zonja Lefterie, zonja Hafizi mund të qëndroni se mund të dalë ndonjë problem.

Pyetje nuk ka më, por mund të ketë nevojë për ndonjë ndërhyrje apo për ndonjë koment.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk e bëj për të bërë qejfin, por doja t'ju falënderoja ju për futjen në rendin e ditës së kësaj nisme, megjithëse ka kohë që është mbajtur.

Më lejoni që në mënyrë të veçantë të falënderoj kolegun Majko për mbështetjen dhe diskutimin konstruktiv që bëri lidhur me këtë çështje.

Në diskutimin tim do të shikoja nismën e grupit të grave deputete, në dy këndvështrime: në aspektin ligjor dhe në atë praktik. Nuk flas për nismën tjetër të kolegëve deputetë, sepse janë çështje teknike dhe rregullime të cilat nuk kanë nevojë për ndonjë diskutim të veçantë.

T'i kthehem nismës së Aleancës së Grave Deputete. Nga pikëpamja ligjore ne tashmë e kemi konfirmuar në Kod problemin e kuotave. Kishte diskutime nga kolegët që kuotat nuk janë zgjidhje ose megjithëse janë vënë, ato nuk janë zbatuar, por unë do të thosha se kuotat në vendin tonë, sidomos në parlament e kanë dhënë rezultatin e tyre: nga shtatë gra që kemi qenë, u bëmë 17. Aktualisht jemi bërë 20% e parlamentit, që u përkasin grave. Ne nuk kemi përmbushur një nga detyrimet ligjore. Si maxhorancë nuk kemi respektuar atë që kemi miratuar në një ligj, i cili miratohet me shumicë të cilësuar. Nga ana tjetër nga pikëpamja ligjore, më lejoni t'i rikthehem Kushtetutës, në Kushtetutë, në kreun e lirive dhe të drejtave të njeriut, në nenin 15 themi se të drejtat janë të padhunueshme.

Në nenin 17, paragrafi i dytë thuhet se në kuadër të interesit publik të drejtat mund të kufizohen.

Po të kalojmë te neni 45 që ka të bëjë me të drejtën e zgjedhjes, aty sanksionohet që çdo shtetas ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet. Jam dakord që gjithkush ka të drejtë të zgjidhet, por me sistemin që kemi zgjedhur ne, sistemin proporcional me lista të mbyllura mundësia për të vënë kandidaturën në kuadër të partive politike, e cila është një nga format më të mira të pjesëmarrjes në politikë, e heq atë mundësi që barazia gjinore, burra apo gra të përfaqësohen me dinjitet.

Përgjigja që më dha kryetarja e komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të them të drejtën më la një shije shumë të hidhur. Mendoja se partitë politike dhe partia ku unë bëj pjesë do të hasnin vështirësi për të gjetur kandidate gra në zonat e thella të vendit, në zonat rurale, por ja që nuk paska ndodhur. Mosplotësimi i listës është pikërisht në qytetet e mëdha. Po t'i referohemi se cilat janë qytetet e mëdha, çfarë kapacitetesh kanë, përbërjen demografike të tyre, institucionet që kanë në gjirinë tyre, them se asnjë parti nuk e ka të vështirë të gjejë gra, të cilat përfaqësojnë me dinjitet gjysmën e popullsisë. Ne kemi miratuar një sërë ligjesh të tjera që bëjnë fjalë për barazinë gjinore, kemi një strategji të veçantë. Kur flasim për 5

prioritetet e integritetit të Shqipërisë në BE, pika e 5 për të cilën do të diskutojmë javën tjetër në kuadër të Komitetit të Stabilizim -Asociimit është pikërisht respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut. Shqipëria është përshëndetur për rritjen e pjesëmarrjes së grave në qeverisje, në drejtimin e administratës në parlament, por kjo nuk duhet të na vetëkënaqë, pasi kemi mundësi për më shumë. Në radhë të parë e kemi detyrim ligjor, të zbatojmë atë nën që ka Kodi Zgjedhor.

E dyta, edhe për ato që kemi në statutin e partive tona. Meqenëse unë i përkas maxhorancës, bie dakord edhe me shqetësimin që ngriti kolegu Fino, se ne duhet të punojmë më shumë brenda partisë, por kjo nuk mund të jetë pengesë të mos luftojmë dhe të zbatojmë në radhë të parë Kodin Zgjedhor të vitit 2008 dhe të bëjmë ndryshimet e duhura për të pasur atë përfaqësim që kemi premtuar për strategjinë, barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës ndaj gruas.

Në rast se i kthehem aspektit praktik, do të doja të ndalesha në praktikën vendase dhe atë të huaj. Jemi ne si maxhorancë që kemi shpalosur modelin më të mirë të vlerësimit të grave në politikë. Jo vetëm që gratë i kemi marrë nga partia, por kemi vlerësuar shumë edhe prurjet nga shoqëria civile, nga jeta akademike. Maxhoranca, por edhe opozita nuk ka mbetur e pakënaqur ose e zhgënjyer nga prurjet që ka sjellë në Kuvendin e Shqipërisë apo nga drejtimi i kolegeve tona si ministre në qeveri, por edhe nga drejtueset gra në institucione të rëndësishme. Sa herë që flasim për sektorë të vështirë dhe të rëndësishëm ku duhet të punohet fort, gjithmonë përmendim gratë. Gjithmonë përmenden gratë si një risi, si gra të zonja, të forta që punojnë dhe janë më pak të korruptuara. Ne, unë të paktën kam dëgjuar kryetarin e partisë sime, Kryeministrin që në muajin shkurt në kuadër të përvjetorit të FRESH-it, i cili deklaroi publikisht në Pallatin e Kongreseve se në këto zgjedhje Partia Socialiste do të përfaqësohet me jo më pak se e 50% të grave në këshillat partiakë.

Në këtë kuadër, do të sugjeroja që ne duhet ta vëmë në Kodin Zgjedhor këtë premtim që kryetari i partisë sonë e dha, e theksoi më shumë se një herë në takimin e hapur publik.

Nga ana tjetër, mendoj se kemi kapacitete edhe për të pasur profesionistë, juristë, ekonomisë, punonjës socialë, inxhinierë e të tjerë në Kuvendin e Shqipërisë dhe në zgjedhjet vendore.

Unë do ta vlerësoja shumë reformën administrative dhe territoriale, riorganizimin që i bëmë. Kjo reformë është një sfidë. Pajtohem me zotin Fino se ajo duhet të provohet. Unë do të thosha se kjo reformë e suksesshme historike, siç ka thënë shpesh zoti Fino, do të jetë

me të vërtetë historike, atëherë kur jo vetëm në këshillat bashkiake, por edhe në drejtimin e 61 bashkive, do të kemi përfaqësuese gra. Ne jemi e vetmja parti që kemi 4 gra kryetare të bashkive dhe ju e dini se sa mirë po ecin bashkitë ku drejtojnë këto gra. Besoj se nuk ka qenë e lehtë. Edhe për to ka qenë e vështirë, por nga ana tjetër këto 61 bashki kanë kompetenca shumë të rëndësishme, ato do të përfaqësojnë probleme të rëndësishme në territorin ku do shtrijnë juridiksionin dhe kompetencat e tyre. Në kuadër të integritetit duhet të punojmë më shumë për mbrojtjen e të drejtave të grave, të fëmijëve në këto bashki, për shërbimet sociale. Kush më mirë sesa gratë mund ta ngrenë zërin dhe për të përfaqësuar gratë e tjera, të cilat nuk kanë mundësi të përfaqësohen të gjitha në administratë, në qeveri apo në parlament? Ne do t'i përfaqësojmë gratë dhe do të ngremë zërin e tyre.

Po t'u drejtohem aspektëve të praktikës ndërkombëtare, ne kemi një përvojë dhe në shumicën e akteve të organizatave ndërkombëtare thuhet se në përbërjen e komiteteve, të delegacioneve vihet ajo që quhet barazia gjinore.

Fatmir Xhafaj - Ju lutem, të respektoni minutazhin!

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë kam besim se ju do ta mbështesni fort këtë iniciativë, sepse kur kemi diskutuar ligjin “Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë”, mund të kemi qenë komisioni, i cili për herë të parë vendosi në një ligj kriterin e barazisë gjinore. Komisioni ynë kërkoi që në Këshillin e Lartë të Drejtësisë të ketë përfaqësim të barazisë gjinore. Kjo është shumë interesante dhe media nuk e ka kapur këtë pikë. Po përfitoj nga rasti për ta theksuar këtë gjë.

E fundit, kam një përgjigje për kolegun Subashi, me gjithë respektin dhe profesionalizmin në parashtrimin e relacionit për nismën e Aleancës së Grave Deputete të përfaqësuar nga tri koleget tona dhe mbrojtur në mënyrë të shkëlqyer nga kolegja Hafizi, do të thosha se duhet të heqim dorë nga ndryshimet e Kodit Zgjedhor apo të ligjeve të tjera të rëndësishme, pak muaj para se të vijë zgjedhjet. Nëse ne nuk e rregullojmë problemin e barazisë gjinore tashmë, zgjedhjet e tjera janë në vitin 2019. Jemi shumë larg. Atëherë, a kërkojmë ne si maxhorancë të shkojmë në BE me përmbushjen e 5 detyrave kryesore? Do të presim ndryshimet që mund t'i bëhen Kodit Zgjedhor në vitin 2016 apo do të presim vitin 2019? Unë kam bindjen se nëse do të gjykojmë pak më mirë dhe me qetësi, do të shikoni se me përfshirjen e grave më shumë në vendimmarrje, këshillat bashkiake do të funksionojnë më mirë, bashkitë po kështu dhe do të ulim nivelin e korrupsionit.

Hajdeni ta diskutojmë!

Ftoj shoqërinë civile të na monitorojë.

Të jeni të bindur se do të jetë shumë më mirë qeverisja e vendit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zonja Caka.

Silva Caka – Faleminderit, zoti kryetar!

Fatmir Xhafaj - Ju lutem të jeni koncizë, pasi kemi një minutazh të caktuar.

Silva Caka – Po, do të flas shumë shkurt, nuk kam për t'u zgjatur.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Silva Caka – Pak më parë u bë objekt diskutimesh nëse kërkesa jonë për t'u refuzuar listat e subjekteve zgjedhore shkel ndonjë parim kushtetues ose jo. Në gjykimin tim vendosja në peshore e parimeve kushtetuese nuk më duket një argument i mirëfilltë ligjor, pasi ashtu siç është parim kushtetues e drejta e subjekteve zgjedhore për të marrë pjesë në zgjedhje, në të njëjtën vlerë është edhe parimi kushtetues i përfaqësimit të barabartë, ose ndryshe i mosdiskriminimit, njëkohësisht edhe e drejta për t'u zgjedhur, siç e përmendëm në lart.

Në rast se kjo gjë nuk vjen natyrshëm, atëherë mua më duket më se e është nevojshme që të nxjerrim një mjet për të balancuar situatën. Ky mjet tashmë është shpikur që nga viti 2008, që është kuota gjinore. Praktikisht kërkesa që Aleanca e Grave Deputeteve ka bërë për të refuzuar listat, nuk ka për qëllim eliminimin e subjekteve zgjedhore nga pjesëmarrja në zgjedhje, por për t'u dhënë atyre një mundësi për t'u përmirësuar në përfaqësimin e tyre në të gjitha nivelet e qeverisjes vendore dhe qendrore. Edhe në rast se këto subjekte zgjedhore nuk arrijnë t'i përmirësojnë listat e tyre dhe në rast se do të ndodhë përjashtimi i tyre nga zgjedhjet, mua nuk më duket më e rëndë sesa barasvlerësimi i një gruaje me 500 lekë të vjetër, apo qoftë edhe me 10 milionë lekë të vjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Absolutisht, ne nuk po e bëjmë 70% gra dhe 30% burra. Kështu që më vjen keq. Nuk ekziston fare viktimizimi në fjalorin tim!

Për sa u përket listave shumemërore, propozimit që ta kufizojmë parashikimin vetëm për këto që po vijmë, nëse nisemi me idenë se çfarë do të ndodhë, po sikur tani, po sikur pastaj, i bie që të mos miratojmë asnjë projektligj, sepse situata është aq dinamike saqë mund të ndryshojë nga momenti në moment dhe ky ligj nuk ka pse të bëjë përjashtim. Kështu që unë nuk mendoj se duhet ta kufizojmë vetëm me këto zgjedhje dhe të presim se çfarë do të ndodhë deri në 2017-n, kur të kemi përsëri zgjedhjet e përgjithshme.

Për sa i përket diskutimit në lidhje me zbatimin e statuteve, meqenëse, zoti Fino mori rastin e PS-së (më falni që po ju referohem), ne dje kemi qenë në një diskutim me ambasadorin e SHBA-ve dhe të gjitha zonjat që ishin aty, përfaqësuese të tre forcave më të mëdha politike në parlament, janë shprehur se ka një kuotë gjinore edhe brenda statuteve. Praktikisht, si përfaqësuese e LSI-së, unë mund t'ju them se ne në statut e kemi të sanksionuar që të gjitha strukturat tona duhet të jenë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë, pra 50% burra dhe 50% gra.

Ju pyetët pse 20% dhe pse 40%? Ju e dini shumë mirë që ne nuk mund ta bënim dot 50%, ashtu siç e thatë, pjesëmarrjen tonë në listat shumëmemërore për këshilltarë të njësive të qeverisjes vendore, sepse këto janë organe kolegjiale, të cilat janë me numër tek dhe nuk ka shanse që ne ta bëjmë me 50%.

Për sa i përket 20%-shit, ju keni qenë edhe kryetari i Komisionit për Reformën Administrative-Territoriale dhe e kuptoni shumë mirë që ky është një realitet, i cili është shumë i freskët dhe shumë i ri, që u është servirur shqiptarëve. Edhe ndryshimet tona nuk do të vijnë në mënyrë të menjëhershme, por gradualisht, ashtu siç është normale për jetën e një shoqërie.

A e zgjidh kjo situatën? Mbase jo plotësisht, por mendoj se kjo është një nga rrugët e duhura për ta zgjidhur plotësisht situatën, e cila na ka sjellë këtu ku jemi sot, ku kemi burra të inkriminuar, ndërkohë që gratë nuk janë të inkriminuara.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Unë i përmbahem një parimi krejt ndryshe, që të jem i sinqertë, për mua nuk ka rëndësi se çfarë janë, burra apo gra, por është shumë e rëndësishme që në Kuvend apo në këshillat bashkiakë të jenë njerëz me integritet dhe me vlera. Nëse janë 70% gra, apo 70% burra nuk ka rëndësi, e rëndësishme është që ata të përfaqësojnë vlerat që ky popull dëshiron të ketë në përfaqësimin e tij në këto institucione. Kjo është më e rëndësishme se çdo diskutim tjetër.

Gjithsesi, secili është i detyruar të llobojë sipas gjinisë.

Zoti Fino, keni fjalën.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, faleminderit!

Zoti Ulsi, zoti Vexhi dhe zoti Subashi, pavarësisht se nuk ju falënderoj Vasilika, paraprakisht po ju falënderoj unë, po flas edhe në emrin tuaj, dhe nuk do të ndihen fare të diskriminuar për çfarë do të them unë për këtë projektligj që është paraqitur!

Ajo që ngrita me të drejtë dhe ju gratë që jeni këtu, edhe ju të shoqërisë civile, që bëni tema dhe konferenca të ndryshme, e dini shumë mirë se problemi nuk zgjidhet me përqindje. Zgjidhja e problemit me përqindje është e sforcuar. Problemi zgjidhet në themel, atëherë kur partitë politike forcojnë dhe rrisin demokracinë e brendshme të tyre dhe zbatojnë statutin e tyre për ato përqindje gjinore që kanë vënë. Atëherë mendoj se kemi arritur një fitore të madhe, për të futur pastaj në mënyrë automatike edhe përqindjet që ju kërkonin në projektligjin përkatës.

Me eksperiencën që kam, edhe si drejtues i pushtetit lokal, edhe si drejtues dhe që e njoh mirë statutin e shumë partive politike, sidomos të partisë sime, kam qenë ndër ta parët (zonja Hysi e di shumë mirë) që kam vënë bashkë me kryetarin aktual dhe Kryeministrin në statutin e partisë këto përqindje për zgjedhjen e grave në tërësi, qoftë në zonat rurale, qoftë në zonat urbane, të cilat le të vijnë natyrshëm në politikën e PS-së, sepse duke ardhur natyrshëm ato do të marrin frytet e asaj zgjedhje nëpër komuna, bashki, legjislacion, pse jo edhe ministre, por edhe më lart.

Më vjen keq të them, për shkak të eksperiencës që kam, që megjithëse edhe ne kemi vendosur përqindje në partinë tonë dhe kemi qenë partia e parë (pavarësisht se tani duhet të falënderojmë LSI-në dhe ta ndjekim, sepse paskan kaluar fifti-fifti) që e kemi vënë në statut, përsëri, për hir të së vërtetës, ja ku janë gratë socialiste këtu, deputete, ka çaluar vërtet puna në sensin e gjetjes së elementëve apo të vënies sipas atyre përqindjeve në strukturat e partisë. Prandaj, unë me koshiençë them që ne duhet të luftojmë një herë brenda për brenda strukturave të partisë.

Çfarë është Kodi Zgjedhor? Kodi Zgjedhor është firma, siç tha kryetari i komisionit, që do të hedhin kryetarët e partive të KQZ-ja për listën shumëmemërore të këshillave përkatës dhe për listën e kandidatëve për kryetar bashkie. Nga kjo pikëpamje unë do të them se jam shumë dakord me projektligjin që kanë paraqitur zonjat, duke përjashtuar neni e parë, për të cilin unë kam vërejtje dhe sugjerime. Unë dua mirëkuptimin e tyre që te neni i parë të mos vëmë përqindje për secilën gjini, aq më tepër që kemi një praktikë të re, po fillojmë me 58 bashki të reja në të gjithë territorin e Shqipërisë. Pra, nuk është më numri 384 njësi vendore, rreth 400 njësi vendore, në të cilat mund ta vinit një përqindje të caktuar. Kjo ndodh për herë të parë dhe la ta provojmë.

Për sa u përket neneve të tjera, absolutisht jam shumë dakord. Jam dakord edhe me përqindjen e këshillave përkatës, 40% e listës shumëmemërore le të jetë e secilës gjini, (ne e

kemi në statutin tonë) dhe do ta rrisë performancën në këto 61 këshilla bashkiakë po të kenë 40% të secilës gjini, cilado qoftë, burra apo gra.

Ky është neni më i rëndësishëm për gratë e këtij Kuvendi që e paraqitën sot. Do të jetë fitorja më e madhe nëse ne e miratojmë. Ju e dini që Kodi kërkon 84 vota. Nëse ne do të miratojmë që KQZ-ja ta kthejë mbrapsht listën që të mos paguhet më gjoba nga partitë politike, atëherë kjo është fitore. Pra, është fitore për t'u treguar partive politike se kur të sjellin listën e një këshilli bashkiak në të duhet të kenë 40% të secilës gjini, qofshin këto gra, apo burra. Jam plotësisht dakord edhe me këtë nen dhe duhet ta përshëndesim.

Për sa i përket nenit të parë kërkoj mirëkuptimin e kolegeve të mia, sepse nuk mund të vihet. A e dini pse? Sepse duhet të fillojmë hap pas hapi, kështu do të kemi mundësi për të treguar sesi kanë performuar këshillat bashkiakë me këtë 40%. Më pas nesër do të kemi mundësi të themi: hajdeni të vëmë përqindjen edhe për kryetar bashkie. Por sot ne këtë përqindje, nëse do ta vëmë, duhet ta vëmë në të gjitha nivelet. Nëse juve po ju qan shpirti për këtë çështje, hajdeni ta vendosim në të gjitha nivelet, duke filluar nga legjislativi, nga ekzekutivi, nga administrata. Pse nuk ka 40% të secilës gjini në Gjykatën e Lartë? Pse nuk ka 40% të secilës gjini në Prokurorinë e Përgjithshme? Pse nuk e ka 40% në qeverinë "Rama" aktuale? Pse nuk ka 40% në parlamentin tonë aktual? Pse nuk ka 40% në administratën e lartë shtetërore, duke përjashtuar vetëm arsimin, që ka një numër më të madh përqindjeje të grave? Atëherë, hajdeni të luftojmë për të gjitha, nëse doni të luftojmë për të gjitha.

A e dini pse vjen ky Kod, zotërinj? Po ju drejtohem juve të shoqërisë civile, sepse duhet ta dini më mirë. Ky Kod bëhet thjesht në funksion të ndarjes territoriale. Pra, bëhen disa ndryshime të vogla, edhe sipas KQZ-së, për shkak të ndryshimit territorial, siç po bëhet edhe ndryshimi i ligjit nr. 8652 "Për pushtetin lokal" për shkak të ndryshimit territorial. Kjo do thotë se nuk do të kemi më 400 këshilla bashkish dhe komunash, por do të kemi 61. Si do t'i kemi? Në funksion të numrit. Ndarjen e ZAZ-ve në 90 pikërisht për këtë po e bëjmë.

Kur të hyjmë në ndryshimin thelbësor të Kodit, në kodin e ardhshëm që mund të bëjmë për zgjedhjet legislative, atëherë kemi hapësira dhe mundësi për të diskutuar më gjatë edhe për barazinë gjinore.

Është gjë e mirë që ndërmerrni një nismë të tillë, por unë pretendoj, zoti kryetar, me shumë pasion, meqë e njoh mirë këtë punë, pasi kam qenë edhe kryetar i Komisionit të Reformës, se do të isha shumë i lumtur ta ngre dorën me kënaqësinë më të madhe për nenet e këtij projektligji, por jo për nenin e parë. Nuk do të votoja kurrësesi që partitë politike të

depozitonin në KQZ listën e kandidatëve për kryetar të njësive vendore deri në 20%, të paktën, të secilës gjini, sepse nuk është oportune tani për tani.

Meqë këto ndryshime i bëjmë thjesht për shkak të kësaj reforme territoriale, atëherë i lëmë vetes më shumë kohë, por edhe opozitës, sepse edhe ajo do të jetë pjesë e diskutimeve, edhe të Kodit Zgjedhor në tërësi, për të bërë pasur një mirëkuptim. Nëse do ta kemi këtë mirëkuptim nga e gjithë klasa politike dhe kryetarët e partive politike, të jeni të bindur, ju dhe ne, nuk po i ndaj sipas gjinisë, se do të jeni të respektuara në formacionet tona politike, nëse forcat politike bëjnë një kod zgjedhor duke mos diskriminuar ndonjë gjini.

Jam kundër asaj që tha Vasilika, jo se po mbroj burrat, por se korrupsioni ka vetëm një ngjyrë – është i zi. Nuk mund të thuash se korrupsionin po e bëjnë burrat apo gratë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

A ka ndonjë gjë tjetër nga deputetët? Nuk ka.

Zonja Shehu.

Mira Shehu – Dua të falënderoj kryetarin për këtë mënyrë diskutimi që u bë këtu, por nga ana tjetër do të doja të falënderoja edhe zotin Fino për mënyrën e diskutimit, sepse në thelb të diskutimit të tij është fakti se nuk ka funksionuar deri tani ajo që po kërkojmë. Me të drejtë, diskutimi duhet të fillojë nga baza. Nëse do ta marrim si një piramidë, ku në majë është parlamenti, ku Aleanca e Grave Deputete po mendon se si të menaxhojë përfshirjen në bazë, do të thosha që puna do të duhet të fillojë nga baza. Nga mosrespektimi i kodit deri tani, do të thotë që aty ka çaluar puna.

Por kjo, zoti Fino, nuk na e heq të drejtën që të gjithave së bashku, si aleancë, por të mos thënë që është diskutuar edhe me grupet e interesit, nëpër zona, që të jenë këto lloj përfaqësish. Jam absolutisht dakord edhe me kryetarin që tha se nuk duhet të flasim me shifra, por me cilësi, sepse është cilësia ajo që na lartëson ne si femra. Nuk është thjesht numri që zëmë, për të thënë se e kemi bërë punën, por ai kontribut që japim, që na barazon dhe na jep atë lloj të drejte të krahasueshme me burrat.

Për hir të së vërtetës, zonja Hysi, edhe unë nuk jam dakord 100% që të korrupsionin mbeten vetëm meshkujt. Nuk mund ta them këtë. Ne kemi treguar që jemi shumë punëtore, transparente dhe këmbëngulëse për të realizuar cilësi. Në lidhje me propozimin e zotit Subashi, që kjo të vendoset për zgjedhjet vendore dhe të mos jetë për zgjedhjet qendrore, nuk jam dakord. Mendoj se kjo duhet të diskutohet tani dhe ta miratojmë së bashku për të marrë formë të prerë, për të korrigjuar ato gabime që mund të ndeshen në zgjedhjet qendrore.

Kjo duhet të shoqërohet nga ne si gra të aleancës, që duhet ta shtrijmë punën tonë më në bazë. Jam dakord me zotën Fino që përqindja duhet të jetë me numra, por ama duhet të jetë një nismë e jona, që të jemi në terren, në të gjitha strukturat, në gjykata, prokurori etj. Ka vende të zhvilluara që te bursat e studimit të vendosen përqindjet për gratë.

Duke filluar të rrisim një kapacitet dhe diapazon të gjerë të grave në vendimmarrje, në pushtetin vendor dhe të gjitha instancat, patjetër që do të për zgjidhen gratë që do të na përfaqësojnë denjësisht.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni!

Arjeta Allhysa – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam një nga gratë që vij nga zonat rurale. Fatkeqësisht apo fatmirësisht, dua që zoti Subashi të hedhë poshtë atë ide që subjektet zgjedhore në zonat rurale nuk kanë përfaqësim të grave. Prania ime në parlament tregon që kemi përfaqësim të grave edhe nga këto zona. Këtu, mbështes edhe zotën Fino. Erdha në parlament nga baza e partisë, duke ngjitur shkallët si anëtare e PS-së, si kryetare e kësaj partie në komunë, në rolin e nënkryetares dhe sekretaresh së rrethit, në rolin e anëtaresh së Asamblesë Kombëtare të PS-së dhe, së fundi, si deputete.

Ne gratë jo se nuk korruptohemi, por e bëjmë punën gjithnjë e më mirë. Po marr shembullin personal: e kam zbatuar statusin e PS-së, duke filluar që në listat e anëtarësisë, ku 30-përqindëshin e kam përfshirë edhe në zonën më të thellë. Edhe në listën e KQZ-së të vitit 2011 për anëtare të këshillave, e kam zbatuar tre në një. Besoj se kjo tregon që gruaja në drejtim jep rezultate, kur gjen mbështetje të fortë edhe nga kolegët.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni!

Adelina Rista– Ju falënderoj, zoti kryetar, që e keni futur në rendin e ditës nismën ligjore të Aleancës së Grave Deputete, sidomos në atmosferën e pas 8 Marsit dhe të pragut të Ditës së Verës. Janë dy ditë që askush nuk mund t'i festojë pa gratë. Ju burrat thoni se ne gratë jemi gjysma juaj më e mirë, por kur vjen puna për përfaqësim në të gjitha nivelet nuk na pranoni si gjysmën tuaj më të mirë. Parë në këtë këndvështrim, ne gratë luftojmë për të vendosur kuota gjinore në respektim të të drejtave që na takojnë.

Jam dakord që kuota gjinore është diskriminim për sa kohë nuk ka barazi, për sa kohë nuk jemi 50% me 50%, por kuota gjinore na lejon ne përfaqësimin në të gjitha nivelet, sepse është një detyrim për partitë politike. Fundi i fundit, ato do ta zbatojnë. Praktika ka treguar që shumë parti politike janë gati të paguajnë gjrobat, sado qofshin ato, vetëm që të mos fusin gra nëpër lista.

Jam plotësisht dakord me shoqen time Silva që duhet të vendos në këtë rast kundër shokut tim të mirë, Armando, sepse praktika e ka treguar që, sado të jetë gjoba, partitë politike do ta paguajnë. Jam dakord që ne gratë duhet të luftojmë brenda partive tona politike – jam plotësisht dakord me zotin Fino – sepse këtu duket se sa seriozisht e kanë partitë politike çështjen me gratë.

Është detyrë e çdo partie politike të tërheqë gratë kudo ku ato janë. Jua them me bindje të plotë se gra ka shumë, por është aftësia e partive që t'i tërheqin në gjirin e tyre, nga të gjitha fushat ku ato janë.

Kuotën gjinore nuk e shoh si një çështje numrash, por si një detyrim për ta na lejuar neve përfaqësimin në të gjitha nivelet. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hafizi.

Mimoza Hafizi – Faleminderit!

Faleminderit të gjithë kolegëve burra për qëndrimin shumë realist dhe mbështetjen! Nuk po i marr emrat në radhë.

Besoj se shkuam në një opinion të përgjithshëm, të fundit, të dhënë nga zoti Fino, të cilin e falënderoj për zemërsisht. Jam shumë e gëzuar që një njeri i cili e njeh kaq mirë realitetin shqiptar, na mbështet në pjesën themelore të ndryshimeve tona, pasi përveç nenit 1, pjesa tjetër është realisht pjesa themelore e ndryshimeve tona.

Për nenin 1, edhe ne e dimë se është një eksperiencë pak e sforcuar, sepse nuk ka ekzistuar në kodin pararendës. Nëse është fjala për të debatuar lidhur me shifrën 20%, jemi dakord. Ndoshta është e mira që ta fusim si mekanizëm dhe të ulim nivelin aq sa ju e mendoni të arsyeshme, në nivel territori edhe në diskutim me opozitën faktikisht në parlament. Nëse ju mendoni që ky mekanizëm të hiqet, ne nuk kemi ndonjë kundërshtim shumë të madh, vetëm se e mira është që ta fusim si një mekanizëm, që ta kemi edhe në vijim. Për shembull, ne propozuam, që të kalojmë nga 1% që jemi tani, në 20%, ju mund të mendoni se është shifër shumë e lartë, mund ta ulim, por le ta kemi si mekanizëm, i cili do të rregullojë modalitetet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që t'i kemi edhe në rastet në

vijim. Nëse ju mendoni që është me të vërtetë e sforcuar, ne jemi dakord që edhe ta tërheqim nenin 1, sepse unë diskutova diçka edhe me Vasilikën. Silva nuk e di, se çfarë mendon ? Por këtë që thashë, ia referoj gjithë diskutimeve që kemi pasur gjatë javëve për të arritur te neni 1. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit: zonja Hafizi, edhe në emër të kolegeve propozuese për çfarë parashtruat!

Unë dua të bëj një saktësim që të jetë e qartë edhe për efekt procedural, por edhe për efekt mediatik. Kjo nuk është një iniciativë e aleancës, aleanca është një një shoqatë, shoqatat nuk kanë të drejtë të propozojnë, nuk kanë iniciativë ligjore këtu është grup deputetësh.

Vasilika Hysi – Dhe aleanca grup deputetësh është, Aleanca e Grave Deputete.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, unë ia toleroj kolegeve, por ju si profesioniste dhe si anëtare e këtij komisioni nuk ju toleroj. Aleanca nuk mund të vijë si aleancë se është shoqatë, dhe shoqata nuk është subjekt i iniciativës ligjore, i një deputeti apo një i grupi deputetësh që janë subjekt të iniciativës ligjore. Më vjen keq Zonja kryetare, që ta mbyllim.

Lefterie Luzi - Atëherë unë do të jem racionale. Do të flasë nga pozitat e Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe do të vazhdoj atje ku e la zonja Hysi.

Sot, ne jemi mbledhur për ndryshimet e Kodit Zgjedhor, për faktin se është emergjencë e ndryshimeve për shkak të një ligji, i cili ka ndryshuar dhe duhet të reflektohet në Kodin Zgjedhor. Ne jemi në mes të një procesi përgatitës zgjedhor që do të thotë se kemi kaluar shumë akte deri tani dhe shumë akte të tjera kemi ngelur pa i kaluar për shkak të këtyre ndryshimeve. Për mua ndryshimet e kuotës gjinore janë shumë të rëndësishme, dhe jam me parimin e zonjës Hysi, jemi 5 muaj para datës së zgjedhjeve, kjo do të thotë që ndryshimet duhen reflektuar edhe në aktet sekondare, edhe në aktet dytësore. Por, a kemi kohë t'i implimentojmë sepse unë gjysmën e akteve i kam kaluar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve? Kjo ka të bëjë me manualët, me trajnimet e të tjera. Kështu që gjithë këto gjëra nuk është se do të reflektojnë vetëm në Kod dhe nuk reflektojnë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhor. Po të shikojmë draftin që është mbi tavolinë, se unë vetëm këtij drafti i jam referuar, ai ka probleme të pikëpamjes së teknikës legjislative. Pika 1 nenit vërtet i referohet nenit 67, por po të shikojmë nenin 67, pikat 1 dhe 2 janë të ndryshme për zgjedhjet parlamentare dhe për organet e qeverisjes vendore. Zonjat deputete i janë referuar KQZ-së si organ që shikon listat, por në zgjedhjet lokale nuk është KQZ-ja, por KZAZ-ja.

Ne kemi kaluar shume akte dhe kemi bërë një punë përgatitore deri tani, e cila në qoftë se do të sjellë si pasojë ndryshimet, do të reflektojë në këto ndryshime, i bie që ne të kthehemi në afate të tjera kohore mbrapa. Prandaj kjo gjë duhet parë, pasi unë nuk jam kundër kalimit të kuotave, unë kam punuar dhe kam sjellë një paketë të tërë këtu vetëm për ndryshimet për kuotën gjinore. Duhet të jemi të kujdesshëm për atë që do të reflektojë, sepse ne e kemi të mirë faktin që në Kod është gjithçka e parashikuar, por problemi është te respektimi.

Pse vakancat? E kemi shumë mirë me vakancat të shkojmë te gruaja, siç është sot e parashikuar në Kod. Pse nuk u zbatua? Se ishte ligji i keq, jo se nuk ishte vullneti politik. Pra, kjo do të thotë hajde të bëjmë ligje, hajde t'i rregullojmë në mënyrë të tillë që të kemi përfitime nga ato, ose të jetë qëllimi që të rrisim numrin e grave.

Kush e ka bërë studimin? A na sjell ne ky ndryshim nesër rritjen e numrit të grave në përfaqësim, në parlament, në këshillat dhe në bashki. Kjo duhet parë dhe është kryesorja, mirëpo për mua edhe për ju, sepse sigurisht ju jeni ligjvënësit, nuk ka kohë për ta bërë një gjë të tillë, dhe kjo ndoshta do ta ulte nivelin e përfaqësimit të grave. Pra, duhet kohë, me Komisionin e Venecias çdo ndryshim ligjor do kohë, të paktën një vit nuk diskutohet, por edhe 6 muaji. Ne nuk jemi përpara këtyre dy kriterëve. Kështu që, unë flas në pozicionin e Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që kam shumë punë për të bërë, kam bërë, por kam akoma, jam në mes të një procesi dhe duhet ta shikoni dhe këtë gjë. Unë e kam punën me afate kohore të parashikuara në ligj. Ne po punojmë dhe të gjitha vendimet i kemi marrë me 7 vota, sigurisht që po. Unë dua të them që duhet të jemi të kujdesshëm në këtë pikë. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Unë po e vazhdoj këtu, ku e la Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, te shqetësimi për afatet, që nuk është formal shqetësim punë datash, por ka të bëjë me thelbin, me ligjshmërinë e procesit dhe kjo është një gjë shumë e rëndësishme, që na obligon për të ecur pak më shpejt se ç'e kishim menduar dhe seç kemi pritshmëri në këtë projekt.

Që të mos i përsërisim më gjërat, dëshiroj të falënderoj koleget tona, që ishin të pranishme në komision. Faleminderit për prezencën, faleminderit për vlerësimet dhe konsideratat tuaja dhe mbi të gjitha për kontributin që dhatë në këtë debat.

Faleminderit propozuesve të kësaj iniciative, kolegëve deputete, por dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që, për hir së të vërtetës, është përpjekur ta shtyjë më përpara këtë

proces, gjithashtu! Faleminderit, kolegëve deputetë, për konstruktivitetin dhe kohën që i kushtuan këtij debati të rëndësishëm!

Një falënderim të veçantë dua ta bëj për aktorët e shoqërisë civile, që e kanë ndjekur këtë debat me shumë interes, për prezencën e tyre, për kontributin aktiv në këtë debat! Gjithashtu, falënderoj përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare që e kanë ndjekur me shumë vëmendje, me shumë interesi me prezencën e tyre, por dhe me kontributin e tyre që kanë dhënë në vijimësi, lidhur me çështjet fort të debatuar edhe në këtë seancë të sotme të komisionit! Faleminderit edhe përfaqësuesve të medias, për durimin që patën! Faleminderit edhe juve zotërinj të Gardës, pavarësisht se është kohë dreke!

Faleminderit të gjithëve!

Tani relatorët së bashku me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe këshilltarët të ulen, të takohen që në këtë moment, për të parë mundësinë që të mos i kalojnë ditën e premtë këto ndryshime. Prandaj zoti Subashi, zonja Luzi dhe këshilltarët të qëndrojnë.

MBLEDHJA MBYLLET